



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "
Financë-Bankë"**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti EPOKA"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Artur Ribaj
2. Dr. Valbona Kapllani

Shtator 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në " Financë-Bankë" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti EPOKA"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti EPOKA
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë-Bankë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Financë-Bankë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.908, datë 26.08.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASNr 213 date 24.10.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër MASH Nr. 286, datë 06.07.2012; VBA Nr. 58, date 28.09.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 (dymbëdhjetë) PAE / 2 (dy) PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 38 (tridhjetë e tetë) studentë; 2021-2022 36 (tridhjetë e gjashtë) studentë; 2022-2023 10 (dhjetë) studentë.
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë-Bankë” është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 908, datë 26.08.2009 dhe ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i Universitetit “EPOKA”.

Universiteti “EPOKA” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 54, datë 16.12.2021 “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të Lartë Universiteti EPOKA”, me kohëzgjatje 6 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 15.12.2027.

Universiteti “EPOKA” është i organizuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015 në tri njësi kryesore:

- Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative;
- Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë;
- Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë-Bankë” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSHEA), që përbëhet nga 3 njësi bazë:

- Departamenti i Financë-Bankës;
- Departamenti i Admintrim Biznesit;
- Departamenti i Ekonomiksit.

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë-Bankë” është akredituar për herë të parë me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 286, datë 06.07.2012. Më pas ky program studimi është riakredituar me Vendimin Nr. 58 datë 28.09.2018 të Bordit të Akreditimit të ASCAL me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite akademike dhe me disa rekomandime në zbatim të këtij vendimi.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Financë-Bankë” është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, si pjesë e fushës së financës dhe sektorit bankar. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky program është i organizuar kryesisht në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmblyëse.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (katër semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Financë-Bankë”. Objektivi kryesor i këtij programi është të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe me aftësi për kërkim shkencor në fushën e financës dhe të sektorit bankar.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 18.05.2023, Universiteti “EPOKA” ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin periodik të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë-Bankë”. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti “EPOKA”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Dy ekspertët në përbërje të grupit të vlerësimit të jashtëm ishin Prof. Dr. Artur Ribaj dhe Dr. Valbona Kapllani, të cilët u asistuan nga Msc. Anilda Beqiraj (Koordinatorë Teknike e ASCAL).

Në datën 22.06.2023 ekspertëve të jashtëm iu dha në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 10 dhe 11 Korrik 2023 në ambientet e Universitetit “EPOKA”. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 17 Korrik 2023.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara nga ekspertët, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master i Shkencave në “Financë-Bankë”.

Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 58, datë 28.09.2018 janë:

1. Institucioni të përmirësojë kurrikulën aktuale duke i dhënë një peshë më të madhe lëndëve të formimit bazë.
2. Institucioni të rishikojë disa prej syllabuseve për të qenë në përputhje me nivelin (si Master i Shkencave) dhe fushën specifike të programit të studimit.
3. Institucioni të fokusohet më tepër në kërkime shkencore të avancuara dhe të drejtohet drejt burimeve të tjera të financimit sidomos me projekte kërkimore të aplikuara me financime ndërkombëtare dhe nga biznesi.


II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Institucioni të përmirësojë kurrikulën aktuale duke i dhënë një peshë më të madhe lëndëve të formimit bazë.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur pjesërisht**. Sikurse raportohet në RVB dhenë dokumentacion shoqërues, plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” parashikon zhvillimin e 13 lëndëve nga të cilat 6 lëndë të detyrueshme. Lëndët e detyrueshme përfshijnë: “Shkrim Akademik”, “Menaxhim Portofoli dhe Analizë Investimesh”, “Menaxhim Bankar”, “Menaxhim Risku dhe Sigurimi”, “Metoda Kërkimi në Ekonomiks dhe Financë” dhe “Temën e diplomës”. Programi i studimit parashikon mundësinë e zgjedhjes përgjatë tre semestrave të 7 lëndëve ndaj 22 lëndëve, në të cilat mbi 50% e lëndëve janë nga fusha e ekonomiks dhe formimit të përgjithshëm. GVJ vlerëson se pesha e lëndëve me zgjedhje është e lartë dhe përtej kufijve të parashikuar nga kuadri rregullator në fuqi dhe një organizim jo i zakonshëm për programe studimi me natyrë të ngjashme.

2. Institucioni të rishikojë disa prej syllabuseve për të qenë në përputhje me nivelin (si Master i Shkencave) dhe fushën specifike të programit të studimit.


GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Programet aktuale të lëndëve (syllabuset) janë formatuar sipas elementëve të kërkuar nga kuadri rregullator në fuqi. Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin e personelit akademik në përditësimin syllabuseve në mënyrë periodike dhe në përputhje me nivelin e studimeve master.



3. Institucioni të fokusohet më tepër në kërkime shkencore të avancuara dhe të drejtohet drejt burimeve të tjera të financimit sidomos me projekte kërkimore të aplikuara me financime ndërkombëtare dhe nga biznesi.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**. Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin e personelit akademik në aktivitete mësimore & kërkimore shkencore si dhe angazhimin e institucionit në funksion të rritjes së mbështetjes financiare për këto aktivitete. UE ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme dhe është i angazhuar në projekte bashkëpunimi kombëtare dhe ndërkombëtare, përmes të cilave synohet të përfitohet ekspertizë bashkëkohore si edhe financim i projekteve kërkimore.

**Më datë 08.09.2023, përmes sistemit AMS dhe shkresë zyrtare Nr 235/19Prot date 08.09.2023
dërgohet në Institucion DRVJ .IAL nuk ka komentet , kështu që drafti kthehet në raport final**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Financë-Bankë" në "Universitetin EPOKA"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti "EPOKA" (referuar shkurt si "UE" në këtë raport vlerësimi) është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili angazhohet në ofrimin e programeve të studimit që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. I themeluar në vitin 2007, UE e zhvillon veprimtarinë në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", me parimet dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë, si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore duke pasqyruar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës.</p> <p>Neni 3 i Statutit të UE shpreh qartë misionin dhe qëllimet e institucionit si një " institucion mësimor dhe kërkimor, novator dhe me ndikim, që iu shërben vlerave njerëzore themelore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të njohurive në nivel ndërkombëtar, si dhe synon të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare dhe rajonale. Për këtë qëllim, Universiteti Epoka synon të përgatisë specialistë, produktivë dhe të aftë, që orientohen drejt kërkimit, me etikë profesionale dhe ndjeshmëri sociale, si dhe të jenë të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare".</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Doc. Shtesë Plani Strategjik për Vitet Akademike, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit "Master i Shkencave në Financë-Bankë" ofrohet nga Departamenti Financë-Bankë i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSHEA). Në Planin Strategjik të këtij Departamenti përcaktohet se "objektivi kryesor i punës është përgatitja e specialistëve të aftë për të punuar në fushën e financës dhe sektorin bankar dhe për të plotësuar nevojat e këtij tregu. Institucioni synon ta realizojë këtë objektivi duke ofruar programe në të tre ciklet e studimit (bachelor, master dhe doktoratë) në fushën e financës dhe sektorin bankar, si dhe përmes aktivitetit kërkimor cilësor të realizuar nga personeli akademik i tij dhe</p>

	<p>në bashkëpunim të ngushtë me institucione financiare dhe publike në vend”.</p> <p>GVJ vlerëson se ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin dhe me fushën e veprimtarisë së UE, të shprehur në Statutin (neni 3) dhe në Strategjinë e institucionit.</p> <p>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 8. Regulation “On Second Cycle Study Programs”.pdf; Annex No. 12. Strategic Plan for Banking and Finance Department.pdf; Doc. Shtesë Plani Strategjik për Vitet Akademike, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”, i ofruar nga Departamenti Financë-Bankë i FSHEA është program i Ciklit të dytë të studimeve, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me një total prej 120 kredite (ECTS).</p> <p>Ky program studimi, që synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe me aftësi për kërkim shkencor në fushën e financës dhe të sektorit bankar, është hartuar në përputhje me kërkesat e Statutit të UE (nenet 79-81 dhe 89-93), të Rregullores së FSHEA (nenet 36-66), si dhe misionin e objektivat e vendosur në Strategjinë e institucionit.</p> <p>Gjithashtu, programi i studimit synon të përgatitë specialistë të aftë në disiplina si menaxhimi bankar, menaxhimi i portofolit dhe investimeve, analiza financiare, menaxhimi i riskut dhe sigurimi, etj (neni 3 i Rregullores së programit të studimit).</p> <p>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 12. Strategic Plan for Banking and Finance Department.pdf; Doc. Shtesë Plani Strategjik për Vitet Akademike, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.pdf; Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ vlerëson se përgatitja e specialistëve me njohuri të thelluara teorike dhe me aftësi për kërkim shkencor në fushën e financës dhe të sektorit bankar është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe prirjet globale. Në Strategjinë e UE përcaktohet se institucioni synon që të jetë një universitet lider në vend në fushën e edukimit, kërkimit dhe zhvillimit, si dhe në shërbim të shoqërisë shqiptare përmes kontributit në burime, zgjidhje novatore, transferimit të dijes dhe punësimit.</p> <p>Megjithatë, duke iu referuar RVB dhe dokumentacionit shoqëruar, GVJ konstaton se dokumentat si Strategjia e UE dhe Plani Strategjik i Departamentit Financë-Bankë i referohen periudhës kohore 2018-2023, prandaj GVJ rekomandon që institucioni duhet të përditësojë dokumentat strategjike në vijim të zhvillimeve në UE.</p> <p>[Referenca: Annex No. 12. Strategic Plan for Banking and Finance Department.pdf; Doc. Shtesë Plani Strategjik për Vitet Akademike, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.pdf; Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p>

	<p>- Programi i studimit është hartuar në përputhje me interesat kombëtare të zhvillimit dhe synon të ruajë dhe konsolidojë vlerat akademike dhe kulturore të shoqërisë.</p> <p>- Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin, Statutin, Strategjinë e zhvillimit dhe me fushat e studimit të UE.</p> <p>- Institucioni duhet të përditësojë dokumentat strategjike në vijim të zhvillimeve në UE.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2																									
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.																									
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti “EPOKA” (UE) i ka fillesat e aktivitetit si Shkollë e Lartë Private në vitin akademik 2007-2008 dhe që prej vitit 2012 me VKM Nr. 553, datë 22.08.2012 gëzon statusin e universitetit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 80/2015.</p> <p>UE përbëhet nga tri njësi kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë; ▪ Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative; ▪ Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSHEA) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Ekonomisë; ▪ Departamenti Financë-Bankë; dhe ▪ Departamenti i Administrim-Biznesit. <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel Fakulteti për tre vitet e fundit përbëhet si vijon:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>PAE /Viti akademik</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Profesor</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Profesor i Asociuar</td> <td>4</td> <td>4</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Doktor/Docent</td> <td>10</td> <td>10</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>7</td> <td>9</td> <td>15</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>24</td> <td>26</td> <td>33</td> </tr> </tbody> </table> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” ofrohet nga Departamenti Financë-Bankë (DFB). Në ciklin e parë të studimeve pranë FSHEA, ky departament mbulon programet e studimit “Bachelor në Financë-Bankë” në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Në ciklin e dytë të studimeve, DFB mbulon edhe programin e studimit “Master Profesional në Financë-Bankë” dhe në ciklin e tretë të studimeve mbulon programin e “Doktoraturës në Financë-Bankë”.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel Departamenti përgjegjës për tre vitet e fundit përbëhet si vijon:</p>	PAE /Viti akademik	2020-2021	2021-2022	2022-2023	Profesor	3	3	5	Profesor i Asociuar	4	4	3	Doktor/Docent	10	10	10	Msc.	7	9	15	Totali	24	26	33
PAE /Viti akademik	2020-2021	2021-2022	2022-2023																						
Profesor	3	3	5																						
Profesor i Asociuar	4	4	3																						
Doktor/Docent	10	10	10																						
Msc.	7	9	15																						
Totali	24	26	33																						

PAE /Viti akademik	2020-2021	2021-2022	2022-2023
Profesor	1	1	1
Profesor i Asociuar	1	0	0
Doktor/Docent	3	5	6
Msc.	4	3	2
Totali	9	9	9

Nga analiza e informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi disa mospërputhje lidhur me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” dhe pranë Departamentit Financë-Bankë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi si informacion shtesë përditësimin e tabelave me informacion mbi personelin akademik.

Nga ky përditësim rezultoi se gjatë vitit akademik 2022-2023, për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 14 pedagogë, nga të cilët 12 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë (PAE) dhe 2 anëtarë të personelit akademik me kontratë (PAK). Gjithashtu, për vitin akademik 2022-2023 nga personeli akademik i angazhuar në programin e studimit 4 pedagogë i përkasin kategorisë Profesor dhe 10 pedagogë i përkasin kategorisë Lektor dhe mbajnë gradën Doktor.

Gjatë viteve akademike 2020 – 2023, programi i studimit është realizuar në masën 56% - 86 % me personel akademik efektiv (PAE).

GVJ konstaton se personeli akademik i këtij departamenti dhe ai i angazhuar në këtë program studimi zotëron përvojën dhe kualifikimet e nevojshme, si dhe disponon kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program studimi.

[Referenca: Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Annex No. 7. The CVs of the Academic Staff engaged in the MSc BAF.pdf; Doc. Shtesë 2023 07 12 Summary Tables RVB_M.Sc. in_BAF_HRO.pdf; vizita në institucion]

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.


Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” është program i ciklit të dytë të studimeve, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, i organizuar në gjuhën angleze, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me një total prej 120 kredite (ECTS), në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015. Ky program studimi që synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe me aftësi për kërkim shkencor në fushën e financës dhe të sektorit bankar, është hartuar në përputhje me kërkesat e Statutit të UE (nenet 79-81 dhe 89-93), të Rregullores së FSHEA (nenet 36-66), si dhe misionin e objektivat e vendosur në Strategjinë e institucionit.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për

Megjithatë, GVJ konstaton se kuadri rregullator i UE i përshkruan në vija të përgjithshme fushat dhe drejtimit akademike të institucionit, ndërsa mungojnë përcaktimet lidhur me fushat akademike e kërkimore të Departamentit Financë-Bankë përgjegjës për programin e studimit.

<p>programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Klasifikimi/kodifikimi i elementëve të programit të studimit është bërë kryesisht në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.</p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të plotësojë kuadrin rregullator me përcaktime më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon Departamenti Financë-Bankë.</i></p> <p><i>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Annex No. 8. Regulation "On Second Cycle Study Programs".pdf; Annex No. 12. Strategic Plan for Banking and Finance Department.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ nuk konstaton evidenca mbi trajnime apo kualifikime profesionale për studentët e diplomuar.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UE ka kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit. - Kuadri rregullator i UE i përshkruan në vija të përgjithshme fushat dhe drejtimet akademike të institucionit, ndërsa mungojnë përcaktimet lidhur me fushat akademike e kërkimore të Departamentit Financë-Bankë përgjegjës për programin e studimit. - Institucioni duhet të plotësojë kuadrin rregullator me përcaktime më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon Departamenti Financë-Bankë. - UE nuk ofron trajnime apo kualifikime profesionale për studentët e diplomuar. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi I.3 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Statuti i UE përcakton strukturat akademike dhe administrative të organizimit të institucionit dhe garanton bashkëpunimin dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiwe mes këtyre strukturave. Rregullorja e UE dhe Rregullorja e njësive kryesore përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësiwë të departamentit, personelit akademik si dhe të personelit ndihmës akademik. Përveç punës mësimore dhe kërkimore, personeli akademik angazhohet edhe në detyra administrative.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, GVJ iu konfirmua se në nivel institucioni, por edhe njësie bazë, realizohen analiza mbi mësimdhënien dhe aktivitetin kërkimor shkencor të personelit akademik. Institucioni përpaket që të nxisë bashkëpunimin mes njësive dhe personelit akademik nëpërmjet organizimit të konferencave, seminareve, tryezave të rrumbullakta dhe aktiviteteve të tjera në funksion të procesit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf; Doc. Shtesë Annex No. 64. Institutional Last Annual Report 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UE ka në fokus të punës së tij bashkëpunimet me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit përmes pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta dhe nënshkrimit të një sërë marrëveshjeve për bashkëpunim me interes reciprok.</p> <p>Aktualisht, në nivel institucioni (UE) janë lidhur 15 marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit, kryesisht për realizimin e mobiliteteve të studentëve dhe të personelit akademik.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 23. List of Students and Staff Mobility.pdf; Annex No. 24. List of Foreign Partnership Agreements.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se plani mësimor i këtij programi studimi nuk parashikon realizimin e praktikës profesionale si pjesë e detyrueshme e programit në kategorinë e lëndëve që ofrojnë njohuri të tjera formuese. Gjithashtu, duke iu referuar RVB, informacionit shoqërues dhe atij të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ nuk ndeshi ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, shoqëri apo sipërmarrje të tjera private për realizimin e praktikave profesionale, qoftë në nivel institucioni apo për këtë program studimi në veçanti.</p> <p>Në RVB theksohet që institucioni inkurajon pjesëmarrjen në veprimtari praktike profesionale, kryesisht gjatë periudhës së verës dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, u konstatua që shumica e studentëve të këtij programi studimi ishin të punësuar gjatë kohës së studimeve.</p>

	<p><i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të punojë më shumë për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike, shoqëri apo sipërmarrje të tjera private me objektiv realizimin e praktikave profesionale në përputhje me natyrën e programit të studimit.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 23. List of Students and Staff Mobility.pdf; Annex No. 24. List of Foreign Partnership Agreements.pdf; vizita në institucion]</i></p>		
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu, bazuar në sa më sipër, GVJ konstatoi se në fund të vitit akademik, Departamenti Financë-Bankë përgatit një raport vjetor ku analizohet ecuria e programeve të studimit por edhe përfitimet kryesore nga marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura. Rezulton se përfitimet kryesore lidhen me mobilitete të personelit akademik dhe të studentëve, realizim të workshop-eve, trajnimeve dhe leksioneve të hapura.</p> <p><i>GVJ rekomandon që analiza e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duhet të formalizohet si raport i dedikuar në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>[Referenca: Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UE ka lidhur 15 marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit, kryesisht për realizimin e mobiliteteve të studentëve dhe të personelit akademik.</i> - <i>Plani mësimor i këtij programi studimi nuk parashikon realizimin e praktikës profesionale si pjesë e detyrueshme e programit në kategorinë e lëndëve që ofrojnë njohuri të tjera formuese.</i> - <i>Pjesë e analizës vjetore të Departamentit janë edhe përfitimet kryesore nga marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura, por nuk ka një raport formal të dedikuar të analizës së këtyre përfitimeve.</i> 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” është hapur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 908 të datës 26.08.2009. Nga shqyrtimi i Planit mësimor dhe syllabuseve të tij, GVJ konstaton se programi është i organizuar në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, të vlerësuara me kredite mësimore sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ky program, që i takon ciklit të dytë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në 4 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën angleze dhe vlerësohet gjithsej me 120 kredite.</p> <p>Konkretisht, plani mësimor parashikon zhvillimin e 13 lëndëve gjithsej, nga të cilat 6 lëndë të detyrueshme. Në dy semestrat e parë zhvillohen dy lëndë të detyrueshme dhe dy lëndë me zgjedhje, në semestrin e tretë zhvillohet një lëndë e detyrueshme dhe tri lëndë me zgjedhje dhe në semestrin e katërt zhvillohet lënda e “temës së diplomës” si detyrim përmbyllës.</p> <p><i>GVJ konstaton se pesha e lëndëve me zgjedhje është e lartë, përtej kufijve të parashikuar nga kuadri rregullator në fuqi dhe programi ka një organizim jo tipik për programet e studimit me natyrë të ngjashme. Plani mësimor nuk parashikon asnjë lëndë në kategorinë D – lëndë plotësuese. GVJ vlerëson se organizimi i disiplinave mësimore dhe veprimtarive të tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi (në 5 kategori, nga A në E), është kryesisht në përputhje me VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 4. Decisions related to the Study Program Curricula of Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike si dhe me aftësi për kërkim shkencor në fushën e financës dhe sektorit bankar. Plani mësimor përfshin lëndë karakterizuese dhe ndërdisiplinore si: “Menaxhimi i Portofolit & Analiza e Investimeve”, “Menaxhimi Bankar”, “Menaxhimi i Riskut & Sigurimi”, “Financa Ndërkombëtare”, “Analiza Financiare”, “Seminare në Financë & Bankë”, “Ligji tatimor në Shqipëri”, “Makroekonomi e aplikuar” dhe “Seritë kohore në Ekonometri” duke ofruar njohuri jo vetëm nga disipinat financiare, por edhe një formim të larmishëm dhe shumëdisiplinor për studentët.</p>

<p>dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve dhe informacionit të marrë në takimet me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se në tërësi lëndët e ofruara në këtë program studimi synojnë t'u japin studentëve njohuri dhe aftësi të avancuara të nevojshme për hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës apo thellimin e njohurive akademike nëpërmjet studimeve pasuniversitare.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 4. Decisions related to the Study Program Curricula of Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Aktualisht plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” nuk parashikon asnjë lëndë në kategorinë D – lëndë plotësuese, të klasifikimit të lëndëve sipas tipit të veprimtarisë (VKM nr. 41, e ndryshuar me VKM nr. 879 dhe VKM nr.185/202). Ndërkohë plani mësimor i këtij programi studimi parashikon lëndën e “Temës së Diplomës” si lëndë e detyrueshme në kategorinë E – detyrime përmbyllëse, për t’u realizuar në semestrin e katërt dhe me 30 kredite (numri i orëve mësimore është 25 orë për kredit).</p> <p>Lidhur me këtë situatë, në takimin e zhvilluar gjatë vizitës në institucion, drejtuesit e UE u shprehën se po punohet për të ndryshuar planin mësimor në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator në fuqi dhe konfirmuan se duke filluar nga viti i ardhshëm akademik praktika profesionale do të përfshihet në planin mësimor si lëndë e detyrueshme dhe me ngarkesën përkatëse në kredite dhe se do të zvogëlohet numri i krediteve për detyrimet përmbyllëse nga 30 në 18 kredite.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 4. Decisions related to the Study Program Curricula of Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësimi i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim</p>	



<p>të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi, sepse Universiteti “EPOKA” nuk është IAL me status të veçantë.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programe studimi të ciklit të dytë, “Master” në fushën e “Financës” ofrohen edhe nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit, por edhe jashtë vendit me disa prej të cilave UE ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Siç u theksua dhe në Kriterin 1 të këtij Standardi, plani mësimor i këtij programi studimi ka një organizim jo tipik për programet e studimit me natyrë të ngjashme, duke qenë se pesha e lëndëve me zgjedhje është e lartë dhe nuk parashikohet asnjë lëndë në kategorinë D – lëndë plotësuese. Konkretisht, në semestrin e parë dhe të dytë pesha e lëndëve me zgjedhje është 50% (dy në katër lëndë janë me zgjedhje) dhe në semestrin e tretë shkon në 75 % (tri në katër lëndë janë me zgjedhje). Gjithashtu, shpërndarja e krediteve sipas lëndëve është e njëjtë nga 7.5 kredite për secilën lëndë me përjashtim të “Temës së Diplomës” që vlerësohet me 30 kredite.</p> <p><i>GVJ vlerëson se kjo mënyrë organizimi nuk garanton krahasueshmërinë në përmbajtje të programit të studimit nga njëri vit akademik në tjetrin, si dhe krahasueshmërinë me programe studime me të njëjtën emërtesë të IAL të tjera. Përveç kësaj nuk respekton kufijtë e parashikuar nga kuadri rregullator në fuqi lidhur me organizimin e planit mësimor sipas tipit të veprimtarisë ku lëndët me zgjedhje përfshihen në kategorinë C dhe nuk duhet të zënë më shumë se 15% të totalit të krediteve.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që të rishihet plani mësimor lidhur me organizimin e lëndëve me zgjedhje në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator në fuqi dhe në funksion të fushës akademike të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 4. Decisions related to the Study Program Curricula of Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</i></p>

Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” është program i ciklit të dytë të studimeve, në fushën e financës dhe sektorin bankar që i përket nivelit të shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve sipas parashikimeve të Ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk zbatohet, sepse programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” nuk është i përbashkët me institucione të tjera të arsimit të lartë.			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit është organizuar kryesisht në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. - Pësha e lëndëve me zgjedhje është e lartë, përtej kufijve të parashikuar nga kuadri rregullator në fuqi dhe programi ka një organizim jo tipik për programet e studimit me natyrë të ngjashme. - Plani mësimor nuk parashikon asnjë lëndë në kategorinë D – lëndë plotësuese. - UE duhet të rishikojë planin mësimor lidhur me organizimin e lëndëve me zgjedhje në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator në fuqi dhe në funksion të fushës akademike të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet
		X		

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqëruar, si dhe informacionet e marra në takimet gjatë vizitës, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet për organizimin dhe strukturën akademike në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” është Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSHEA) të UE. Ky fakultet sëbashku me Fakultetin e Arkitekturës & Inxhinierisë dhe Fakultetin e Drejtësisë & Shkencave Sociale janë tri njësitë kryesore të Universitetit “EPOKA”, i riorganizuar sipas Urdhërit të MAS Nr. 116, date 13.03.2017.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse e këtij programi studimi është Departamenti Financë-Bankë (DFB), që sëbashku me Departamentin e Ekonomiksit</p>

dhe Departamentin e Administrimit të Biznesit përbëjnë njësitë bazë të zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore dhe shkencore në FSHEA.

UE ka marrë akreditimin e parë institucional nga ASCAL me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 92, datë 20.10.2017 dhe është riakredituar më pas, me vlerësimin përfundimtar pozitiv dhe me kohëzgjatje gjashtë vite, me VBA Nr. 54 të datës 16.12.2021.

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, gjatë vitit 2022-2023, personeli akademik i secilit departament të FSHEA ka përbërjen e mëposhtme:

Departamentet e FSHEA	PAE	PAK	Totali
Dep. i Ekonomiksit	7	0	7
Dep. Financë-Bankë	9	11	20
Dep. i Administrimit të Biznesit	17	11	28
Totali	33	22	55

Secili departament plotëson numrin minimal të personelit akademik efektiv të kërkuar sipas nenit 35 të Ligjit nr. 80/2015.

Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” ka marrë fillimisht vlerësimin e akreditimit me Urdhërin e MAS Nr. 260, datë 07.06.2011. Më pas, i është nënshtruar akreditimit periodik nga ASCAL dhe me VBA Nr.58, datë 28.09.18 ka marrë vlerësimin pozitiv të akreditimit me kohëzgjatje pesë vite akademike dhe me disa rekomandime për të cilat GVJ është shprehur në fillim të këtij raporti.

Bazuar në evidencën shitesë të vënë në dispozicion me kërkesën e GVJ gjatë vizitës në institucion, personeli akademik i angazhuar pranë Departamentit Financë-Bankë (DFB) në funksion të këtij programi studimi gjatë tre viteve të fundit akademike paraqitet si vijon:

Departamenti DFB	PAE	PAK	Totali	Raporti PAE/PAK
2020-2021	11	3	14	79%
2021-2022	9	7	16	56%
2022-2023	12	2	14	86%

Nga shqyrtimi i informacioneve të mësipërme, GVJ konstaton se:

- Personeli efektiv i angazhuar pranë Departamentit Financë-Bankë plotëson kriteret lidhur me numri minimal që kërkohet nga Ligji nr. 80/2015, por raporti i personelit efektiv ndaj totalit të personelit akademik ka pësuar rënie në vitin akademik 2021-2022.
- Mesatarisht, vetëm 3-4 personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi si personel efektiv i takojnë Departamentit Financë-Bankë, pjesa tjetër u takojnë Departamenteve dhe Fakulteteve të tjera të UE.

	<p><i>GVJ rekomandon që duhet të rritet numri i personelit akademik efektiv në mënyrë që institucioni të mos ketë probleme në burime njerëzore në rast largimi të një pedagogu efektiv, duhet të rritet mbulimi me personel efektiv dhe lëndë që ofrohen nga Departamenti Financë-Bankë si dhe duhet të plotësohet dokumentacioni lidhur me burimet njerëzore të angazhuara në programin e studimit në mënyrë të plotë dhe të qartë.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Doc. Shtesë 2023 07 12 Summary Tables_RVB_M.Sc._in_BAF_HRO.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Siç u përmend më sipër, programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” aktualisht nuk parashikon kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se pranë Departamentit Financë-Bankë (DFB) është e angazhuar në rolin e koordinatores së departamentit një punonjëse, e cila mbulon detyra administrative dhe ndihmës akademike sipas parashikimeve të kuadrit rregullator të UE. Punonjësja ishte edhe pjesë e grupit hartues të RVB për këtë program studimi.</p> <p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i UE (Statuti, Rregullorja e UE dhe Rregullorja e FSHEA) shprehet në mënyrë të përgjithshme lidhur me personelin ndihmës akademik, nuk shprehet për rolin e koordinatorit të departamentit, si dhe nuk parashikon detyra specifike që duhet të realizojë ky rol në aktivitetin e departamentit apo lidhur me realizimin e programit të studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që kuadri rregullator i UE duhet të përditësohet dhe të plotësohet edhe me detyrat specifike që duhet të realizojë personeli ndihmës akademik pranë njësive bazë.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_jMSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Doc. Shtesë 2023 07 12 Summary Tables_RVB_M.Sc._in_BAF_HRO.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në informacione e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqëruar dhe informacionin e marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se Përgjegjësi i Departamentit Financë-Bankë (DFB) konsiderohet njëkohësisht edhe koordinatori i të gjitha programeve të studimit që mbulon njësia bazë pasi, sipas Statutit të UE (neni 12, pika 1), departamenti është përgjegjës për ecurinë e programeve të studimit që ofron si dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë në to.</p> <p><i>GVJ vlerëson se kjo mënyrë organizimi, pavarësisht numrit të kufizuar të programeve të studimit dhe personelit akademik të angazhuar në to, sjell mbivendosje të detyrave dhe përgjegjësive të cilat mund të ndikojnë cilësinë e realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që kuadri rregullator i UE duhet të përditësohet dhe të plotësohet edhe për këtë aspekt, në përputhje me kërkesat e kuadrit</i></p>



	<p>rregullator në fuqi lidhur me rolin e koordinatorit të programit të studimit.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Doc. Shtesë 2023 07 12 Summary Tables_RVB_M.Sc._in_BAF_HRO.pdf; vizita në institucion]</p>		
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi Fakulteti i Shkencave Ekonomike & Administrative dhe Departamenti i Financë-Bankës i përmbushin standardet ligjore lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive. - Pjesa më e madhe e personelit akademik efektiv të angazhuar pranë këtij programi studimi nuk i përket Departamentit Financë-Bankë. - Pranë DFB është e angazhuar në rolin e koordinatores së departamentit një punonjëse, por kuadri rregullator i UE duhet të përditësohet dhe të plotësohet edhe me detyrat specifike që duhet të realizojë personeli ndihmës akademik pranë njësive bazë. - Përgjegjësi i DFB konsiderohet njëkohësisht edhe koordinatori i të gjitha programeve të studimit që mbulon njësia bazë. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, dokumentacionin shoqëruar dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Shkencave Ekonomike & Administrative (FSHEA) dhe Departamenti Financë-Bankë (DFB) kanë hartuar rregullore dhe kanë përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e programit të studimit duke përfshirë planin mësimor, syllabuset e lëndëve, informacionin mbi stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, etj.</p> <p>Megjithatë, siç u trajtua edhe në Standardin I.2 të Fushës I (kriteri 3), kuadri rregullator i UE i përshkruan në vija të përgjithshme fushat dhe drejtimet akademike të institucionit, ndërsa mungojnë përcaktimet lidhur me fushat akademike e kërkimore të Departamentit Financë-Bankë përgjegjës për programin e studimit (nuk ka një rregullore të Departamentit Financë-Bankë).</p> <p>GVJ rekomandon që kuadri rregullator i UE duhet të përditësohet dhe të plotësohet me përcaktime më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon departamenti.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study</p>

	<p><i>program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Annex No. 8. Regulation "On Second Cycle Study Programs".pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit "Master i Shkencave në Financë-Bankë" përmban informacion në lidhje me ngarkesën mësimore sipas semestrave, orët në auditor dhe jashtë auditorit dhe vlerësimin me kredite. Ky program, që i takon ciklit të dytë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në 4 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën angleze dhe vlerësohet gjithsej me 120 kredite. Plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin gjatë 2 viteve akademike të 3'000 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 576 orë mësimore në auditor leksione; ▪ 48 orë mësimore në auditor për temën e diplomës; ▪ 2'376 orë punë e individuale jashtë auditorit. <p>Nga analiza e planit mësimor sipas veprimtarive formuese dhe vlerësimit të tyre me kredite sipas parashikimeve të VKM nr. 41 (i ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr.185/2021) GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Në kategorinë A – përfshihen dy lëndë bazë me 15 ECTS që zënë 12.5% të krediteve (përtej kufijve ligjorë 5% - 10% të krediteve); ▪ Në kategorinë B – përfshihen gjashtë lëndë karakterizuese, nga të cilat tri me zgjedhje, me 45 ECTS zënë 37.5% të krediteve (nën kufirin 50% - 60% të krediteve); ▪ Në kategorinë C – përfshihen katër lëndë ndërdisiplinore, të gjitha me zgjedhje, me 30 ECTS zënë 25% të krediteve (përtej kufijve 12% - 20% të krediteve); ▪ Në kategorinë D – lëndë plotësuese, nuk përfshihet asnjë lëndë (nën kufirin prej 10% të krediteve); ▪ Në kategorinë E – përfshihet tema e diplomës si detyrim përmblylës me 30 ECTS zënë 25% të krediteve (përtej kufirit 10% -15% të krediteve). <p>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlllogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është përlllogaritur 25 orë pune e studentit, ku përfshihen orë mësimore në auditor (de jure vetëm leksione), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>GVJ vlerëson se shpërndarja aktuale e lëndëve në secilën kategori nuk është plotësisht në përputhje me fokusin e çdo lënde dhe pesha e lëndëve me zgjedhje shkon përtej kufijve të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi duke penguar krahasueshmërinë në përmbajtje të programit të studimit nga njëri vit akademik në tjetrin.</p> <p><i>GVJ rekomandon që të rishihet plani mësimor lidhur me shpërndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese dhe organizimin e lëndëve me</i></p>

	<p>zgjedhje, në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator në fuqi dhe në funksion të fushës akademike të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 4. Decisions related to the Study Program Curricula of Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator të UE, GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera parashikohen në terma të përgjithshëm në Statut (nenet 89-93), në Rregulloren e UE (nenet 32 & 37), në Rregulloren e FSHEA (nenet 40-41 & 46) në Rregulloren (e përbashkët) të Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë (nenet 13-15 & 24) dhe në Rregulloren e Programit të Studimit (nenet 5-7 & 9) .</p> <p>Sipas parashikimeve në këto rregullore, pranimi në këtë program studimi është i mundur për studentët që zotërojnë një diplomë të Ciklit të Parë në shkencat ekonomike, të përfunduar në një IAL brenda ose jashtë vendit të njohur nga MAS, dëshmojnë njohjen e gjuhës angleze në nivelin B2 sipas Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët (CEFR) dhe pranojnë të paguajnë tarifën e përcaktuar të studimeve.</p> <p>Udhëzuesi i UE “Mbi Transferimin e Studentëve“ jep informacion të plotë lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për njohjen dhe ekuivalentimin e periudhave të mëparshme të studimit pranë UE.</p> <p>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 8. Regulation “On Second Cycle Study Programs”.pdf; Annex No. 47. Directive On Student Transfer.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit dhe programet e çdo lënde (syllabuset) janë të unifikuar dhe kryesisht të hartuar sipas formatit të kërkuar nga VKM nr. 41 (i ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr.185/2021). Ato përmbajnë informacionin e domosdoshëm për zhvillimin e një lënde: ngarkesën mësimore, semestrin kur zhvillohet, konceptet themelore të lëndës, temat që zhvillohen çdo javë, rregullat e frekuentimit dhe vlerësimit të dijeve në lëndë, literaturën bazë dhe atë ndihmëse, etj.</p> <p>[Referenca: Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm</p>	<p>Në takimin me personelin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se në fund të çdo viti akademik, në mbledhjen e Departamentit Financë-Bankë diskutohet mbi syllabuset e programit të</p>

<p>dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>studimit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e tyre, si një proces i vazhdueshëm dhe që ndikon në rritjen e cilësisë së programit të studimit. Propozimet e Departamentit për ndryshime në programin mësimor i drejtohen Dekanatit të FSHEA, për miratimin paraprak dhe më pas ndiqen dhe vlerësohen nga ana e Komisionit për Zhvillimin e Kurrikulës dhe Komisioni i Përheshëm i Sigurimit të Cilësisë sipas parashikimeve në “Manualin e Sigurimit të Cilësisë të UE”.</p> <p>Bazuar në informacionin shoqërues të RVB, vendimi nr.5 datë 28.09.2017 i Senatit të UE, GVJ konstaton se ky program studimi ka pësuar ndryshime, por nuk rezulton i qartë motivi dhe natyra e ndryshimeve përveç shpërndarjese në mënyrë uniforme të krediteve (nga 7.5 kredite për secilën lëndë).</p> <p><i>GVJ vlerëson se ndryshimet në programin e studimit duhet të dokumentohen në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe se praktika rregullatore e UE duhet të përditësohet për këtë aspekt.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 4. Decisions related to the Study Program Curricula of Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 39. EPOKA Quality Assurance Handbook.pdf; Doc. Shtesë Tabela e Ndryshimeve të Kurrikulës.pdf; vizita në institucion]</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UE disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, por kuadri rregullator i UE duhet të përditësohet dhe të plotësohet me përcaktime më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon departamenti. - Shpërndarja aktuale e lëndëve në secilën kategori të planit mësimor nuk është plotësisht në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve me zgjedhje shkon përtej kufijve të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi duke penguar krahasueshmërinë në përmbajtje të programit të studimit nga njëri vit akademik në tjetrin. - Ky program studimi ka pësuar ndryshime në vitin 2017, por praktika e dokumentimit të ndryshimeve nuk është e plotë. 						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="539 1384 754 1462">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="754 1384 943 1462">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="943 1384 1161 1462">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="539 1462 754 1505"></td> <td data-bbox="754 1462 943 1505" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="943 1462 1161 1505"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” është një program i ciklit të dytë të studimeve, në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomën “Master i shkencave”. GVJ vlerëson se ky program përmban lëndë specifike të fushës së financës dhe sektorit bankar, por</p>

<p>dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>edhe lëndë që synojnë t' i japin studentit një formim të përgjithshëm edhe në fushën e ekonomikut, menaxhimit dhe kërkimit shkencor duke u mundësuar studentëve thellimin e njohurive dhe aftësive të tyre për studime të mëtejshme dhe në funksion të punësimit të tyre. Por GVJ konstaton se krahasuar me programe studimi të ngjashme në nivel kombëtar, ky program studimi nuk parashikon kryerjen e praktikës profesionale dhe se lëndët me zgjedhje zënë një peshë të rëndësishme në planin mësimor.</p> <p><i>Prandaj, GVJ rekomandon që të rishihet plani mësimor lidhur me shpërndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese dhe organizimin e lëndëve me zgjedhje, në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator në fuqi dhe në funksion të fushës akademike të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit.</i></p> <p><i>[Referenca: Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” i takon ciklit të dytë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në 4 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën angleze dhe vlerësohet gjithsej me 120 kredite. Plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin gjatë 2 viteve akademike të 3000 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 576 orë mësimore në auditor leksione; ▪ 48 orë mësimore në auditor për temën e diplomës; ▪ 2'376 orë punë e individuale jashtë auditorit. <p>Vlerësimi në kredite i lëndëve është bërë në mënyrë të barabartë nga 7.5 kredite për secilën lëndë. Një kredit është përlllogaritur 25 orë pune e studentit, ku përfshihen orë mësimore në auditor (de jure vetëm leksione), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>GVJ vlerëson se shpërndarja aktuale sipas semestrave dhe vlerësimi në kredite i lëndëve mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional në fushën e financës dhe sektorit bankar.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të</p>	<p>Bazuar në planin mësimor dhe programet e lëndëve dhe nga takimet me personelin akademik dhe studentë, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit dhe shpërndarja e orëve mësimore (leksione në auditor) dhe krediteve në dy vite akademike është e balancuar.</p> <p>Siç u përmend edhe në Standarin II.1 të Fushës II, ky program studimi ka një organizim jo tipik për programet e studimit me natyrë të ngjashme, duke qenë se pesha e lëndëve me zgjedhje është e lartë dhe nuk</p>

sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	parashikohet kryerja e praktikës profesionale apo e lëndëve plotësuese (kategoria D). Gjithashtu në grupin e lëndëve me zgjedhje mbi 50% e lëndëve janë nga fusha e ekonomiksit dhe formimit të përgjithshëm.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Duke iu referuar vetëm orëve mësimore në auditor, plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin në dy vite akademike të sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Teori (leksione & diploma) 624 orë mësimore në auditor; ▪ Praktikë (seminare/ ushtrime & detyra kursi) 0 orë në auditor. <p>Kjo mënyrë organizimi e bën të pamundur vlerësimin objektiv të formimit praktik, pavarësisht se në takimet e zhvilluara me drejtues dhe personelin akademik të UE gjatë vizitës në institucion, ata u shprehën se orët mësimore në auditor, në këtë program studimi nuk janë thjesht leksione teorike, por përfshijnë edhe aktivitete praktike si detyra kursi, raste studimore, projekte, teste etj.</p> <p>GVJ vlerëson se njohuritë e ofruara në këtë program studimi janë kryesisht të mjaftueshme për të formuar një specialist të fushës së financës dhe sektorit bankar përsa i takon njohurive të parashikuara në nivelin e studimeve Master.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</i></p>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se programet e lëndëve rishikohen çdo fund viti akademik dhe literatura e detyrueshme dhe ndihmëse përditësohet me literaturën bashkëkohore kryesisht në gjuhën angleze.</p> <p><i>[Referenca: Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion]</i></p>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Programi i studimit synon të përgatitë specialistë të aftë në disiplina si menaxhimi bankar, menaxhimi i portofolit dhe investimeve, analiza financiare, menaxhimi i riskut dhe sigurimi, etj (neni 3 i Rregullores së programit të studimit). Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se në përgjithësi përmbajtja e programeve të lëndëve lejon fitimin e dijeve, kompetencave dhe aftësive të synuara në secilën lëndë.</p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Gjithashtu GVJ vlerëson se përmbajtja e këtij programi studimi u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë (doktoraturë) apo punësimin dhe ndjekjen e kualifikimeve profesionale në fushën e financës.</p> <p><i>[Referenca: Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. Shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; vizita në institucion]</i></p>
Konkluzione	GVJ konstaton se:

	<p>- <i>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, janë kryesisht në përputhje me profilin e programit master në fushën e financës.</i></p> <p>- <i>Organizimi aktual i veprimtarive formuese të programit të studimit e bën të pamundur vlerësimin objektiv të formimit praktik.</i></p> <p>- <i>Përmbajtja e programit të studimit garanton kryesisht përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara si dhe vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë, punësimin apo ndjekjen e kualifikimeve profesionale në fushën e financës.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UE ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme dhe është i angazhuar në projekte bashkëpunimi, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron. Këtij qëllimi synon t'i shërbejë edhe krijimi me vendimin e Senatit të UE i "Forumit të Palëve të Interesit të FSHEA" me përfaqësues nga tregu i punës me objektiv bashkëpunimin me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit të ofruara apo të reja nga institucioni. Gjatë vitit 2023, UE ka realizuar edhe një studim mbi nevojat e tregut të punës dhe aftësitë e kërkuara për studentët e fushës së financës dhe bankës. Studimi bazohet në analizën përshkruese të rezultateve të një anketimi, të realizuar me shoqëritë pjesëmarrëse në Panairin e Karrierës të organizuar nga UE në maj 2023.</p> <p><i>GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për përmirësim të programeve të studimit përmes përfshirjes së grupeve të interesit dhe hulumtimit të tregut të punës por gjykon se kjo praktikë dhe analizat bashkëshoqëruese duhet të jenë më të formalizuara, me takime të rregullta dhe të dokumentuara, si dhe me propozime konkrete për programin e studimit.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 11. Decision of the Academic Senate of EPOKA University No. 07, dated 21.12.2022 Advisory Board.pdf; Annex No. 24. List of Foreign Partnership Agreements.pdf; Annex No. 57. List and Brief Description of the Acquired and Implemented Research Projects.pdf; Doc. shtesë Raport mbi Studimin e Tregut të Punës.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me</p>	<p>GVJ konstaton se UE ka siguruar përfshirjen e opinionit të studentëve përmes pjesëmarrjes së tyre në Senatën Akademik të UE, në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, në Këshillin (Bordin) e Etikës, në Komisionin e Përhershëm të Marrëdhënieve me Studentët si edhe pranë</p>

<p>studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të institucionit.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua organizimi dhe funksionimi i Këshillit Studentorë. Gjithashtu, Zyra e Dekanit të Studentëve me strukturat e saj si Zyra e Planifikimit të Karrierës & të Diplomuarve, përmes pyetësorëve për studentët aktualë dhe të diplomuar, mbledh opinionet e studentëve edhe lidhur me përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 9. Decision of the Rectorate of EPOKA, Alumni Survey.pdf; Annex No. 49. Statute of Student Council.pdf; Annex No. 52. Student Satisfaction Survey.pdf vizita në institucion]</i></p>								
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti Financë-Bankë (DFB) është i angazhuar në përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimit në përputhje me zhvillimet e fundit të fushës dhe kërkesat e tregut të punës përmes integritit të eksperiencave të krijuara nga projektet dhe aktivitetet e ndryshme në nivel institucioni dhe më gjerë.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 57. List and Brief Description of the Acquired and Implemented Research Projects.pdf; vizita në institucion]</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UE ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme dhe është i angazhuar në projekte bashkëpunimi, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron. - Përpjekjet e institucionit për përmirësim të programeve të studimit përmes përfshirjes së grupeve të interesit dhe hulumtimit të tregut të punës duhet të jenë më të formalizuara, me takime të rregullta dhe të dokumentuara, si dhe me propozime konkrete për programin e studimit - DFB është i angazhuar në përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimit përmes integritit të eksperiencave të krijuara nga projektet dhe aktivitetet e ndryshme në nivel institucioni dhe më gjerë. 								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="539 1330 756 1413">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="756 1330 940 1413">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="940 1330 1157 1413">Përbushet</th> <th data-bbox="1157 1330 1394 1413">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="539 1413 756 1449"></td> <td data-bbox="756 1413 940 1449"></td> <td data-bbox="940 1413 1157 1449"></td> <td data-bbox="1157 1413 1394 1449" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet	Përbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se objektivat kryesorë të paraqitur në Rregulloren e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” janë në përputhje me objektivat kryesorë të UE të paraqitura në Statut dhe në Strategjinë e institucionit.</p> <p><i>GVJ konstaton se dokumentat strategjike i referohen kryesisht periudhës 2018-2022 prandaj rekomandon përditësimin e tyre në përputhje me</i></p>



	<p><i>objektivat dhe prioritetet e institucionit, por edhe të këtij programi studimi për vitet në vijim.</i></p> <p><i>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 8. Regulation "On Second Cycle Study Programs".pdf; Annex No. 12. Strategic Plan for Banking and Finance Department.pdf; Annex No. 13. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf; Doc. shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Shkencave Ekonomike & Administrative (FSHEA) dhe Departamenti Financë-Bankë (DFB) mbështesin personelin akademik në procesin e mësimdhënies dhe në aktivitetin e tij kërkimor dhe shkencor duke respektuar lirinë e tij akademike.</p> <p>Në Statutin e UE (neni 5 & 69) parashikohet liria akademike përmes grantimit të së drejtës për organizimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore dhe krijuese (hartim, zhvillim dhe zgjedhje fushash të kërkimit shkencor) si dhe të drejtës për promovim të personelit akademik.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson dhe nxit angazhimin e studentëve në projekte dhe aktivitete të tjera shkencore kryesisht përmes përfshirjes së tyre në klubet studentore, në mobilitete të projektit Erasmus+ dhe në aktivitetet e parashikuara të programit mësimor (përgatitja e temës së diplomës, detyrat e kursit dhe projekte).</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 22. EPOKA University Regulation "On Student Exchange".pdf; Annex No. 23. List of Students and Staff Mobility.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Gjithashtu nga shqyrtimi i kuadrit rregullator të UE dhe në takimin me personelin akademik të këtij programi studimi, GVJ mori konfirmim e mbështetjes financiare që institucioni i jep personelit akademik për realizimin e aktiviteteve kërkimore, studimore dhe shkencore.</p> <p>Konkretisht, institucioni ka hartuar rregullore dhe udhëzues të posaçëm për mbështjen financiare të aktiviteteve kërkimore, promovimin dhe shpërblimin në bazë të performancës të personelit akademik. Aktivitetet studimore dhe projektet kërkimore, përfshirë edhe mbështetjen financiare të tyre, koordinohen në nivel institucioni nga Zyra e Kërkimeve & Projekteve, strukturë në varësi të Rektorit të UE.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 19. EPOKA University Policy "On Participation of Academic and as Academic Staff".pdf; Annex No. 27. EPOKA University Directive "On Academic and Administrative Performance Assessment and Quality Improvement".pdf; Doc. shtesë Analiza e të Dhënave Financiare për Programin e Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; Annex No. 57. List and Brief Description of the Acquired and Implemented Research Projects.pdf; Annex No. 60. List of Publications of Staff.pdf; Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p>

	<p>- <i>Kuadri rregullator i UE përcakton objektivat e programit të studimit në përputhje me objektivat kryesorë të institucionit, por disa dokumenta strategjikë duhet të përditësohen në përputhje me objektivat dhe prioritetet e institucionit por edhe të këtij programi studimi për vitet në vijim.</i></p> <p>- <i>UE garanton lirinë akademike të personelit akademik.</i></p> <p>- <i>Programi i studimit u mundëson studentëve angazhimin në mobilitete, projekte dhe aktivitete kërkimore të institucionit.</i></p> <p>- <i>UE angazhohet për mbështetjen financiare të kërkimit shkencor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet	Përmbyshet	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objekti vave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe të marrë nga vizita në institucion, GVJ konstaton angazhimin e UE në mbështetjen e personelit akademik për realizimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore si dhe në sigurimin e bashkëpunimit mes strukturave të institucionit për realizimin e objektivave të programit të studimit. Në Strategjinë e UE, ofrimi i një mjedisi cilësor për kërkimin dhe realizimin e projekteve përcaktohet si një nga tre prioritetet e zhvillimit në përputhje me vizionin e institucionit. Gjithashtu, UE ka hartuar rregullore dhe udhëzues të posaçëm për nxitjen dhe mbështetjen financiare të aktiviteteve kërkimore, promovimin dhe shpërblimin në bazë të performancës të personelit akademik. Aktivitetet studimore dhe projektet kërkimore, përfshirë edhe mbështetjen financiare të tyre, koordinohen në nivel institucioni nga Zyra e Kërkimeve & Projekteve, strukturë në varësi të Rektorit të UE.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 19. EPOKA University Policy "On Participation of Academic and as Academic Staff".pdf; Annex No. 27. EPOKA University Directive "On Academic and Administrative Performance Assessment and Quality Improvement".pdf; Annex No. 54. Regulation "On Scientific Research".pdf; Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf; Doc. shtesë Plani Strategjik për Vitet Akademike, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se UE mbështet dhe nxit personelin akademik dhe studentët për t'u anagazhuar në projekte dhe analiza me karakter kërkimor shkencor. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, rezulton se personeli akademik i DFB dhe studentët e këtij programi studimi kanë marrë pjesë në mobilitete dhe në projekte Erasmus+, në konferenca ndërkombëtare dhe lokale. Megjithatë GVJ konstaton që angazhimi në këto projekte nuk lidhet drejtpërdrejt me fushën e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë-Bankë". Prandaj GVJ rekomandon që DFB duhet t'i kushtojë</p>

	<p><i>më shumë vëmendje angazhimit në projekte që lidhen drejtpërdrejt me fushën e financës.</i></p> <p><i>[Referenca: Annex No. 18. List of Training Activities.pdf; Annex No. 57. List and Brief Description of the Acquired and Implemented Research Projects.pdf; Annex No. 58. List of Staff Engaged in Projects.pdf; Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Referuar dokumentacionit vënë në dispozicion, GVJ konstaton angazhimin e personelit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi në aktivitete shkencore dhe projekte kërkimore në nivel institucioni si trajnime dhe leksione të hapura me specialistë të fushës, konferenca studentore dhe ndërkombëtare, projekte të Erasmus + etj.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 18. List of Training Activities.pdf; Annex No. 57. List and Brief Description of the Acquired and Implemented Research Projects.pdf; Annex No. 58. List of Staff Engaged in Projects.pdf; Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” synon të formojë studiues dhe njohës të mirë të fushës së financës dhe sektorit bankar, përmes aplikimit të zhvillimeve bashkëkohore në kërkim. Gjithashtu programi i studimit synon të nxisë kërkimin e aplikuar dhe thellimin e kufijve të njohjes në këtë fushë (neni 3 i Rregullores së programit të studimit). Zhvillimi i programit mësimor në gjuhën angleze, u jep studentëve një avantazh në tregun kombëtar dhe rajonal të punës.</p> <p>Megjithatë siç u përmend edhe më sipër, (Standardet II.1, II.3 & II.4) GVJ rekomandon rishikimin e planit mësimor, lidhur me organizimin e lëndëve me zgjedhje dhe përfshirjen e praktikës profesionale apo dhe të ndonjë lënde nga fusha e sistemeve të informacionit si lëndë plotësuese (të kategorisë D) edhe për të rritur konkurrueshmërinë në tregun e punës, të të diplomuarve të këtij programi studimi.</p> <p><i>[Referenca: Doc. shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; Tabela e Ndryshimeve të Kurrikulës.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe të marrë nga vizita në institucion, GVJ konstaton angazhimin e institucionit për të marrë në konsideratë sugjerimet dhe rekomandimet e nxjerra nga organizatat profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e aktiviteteve mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore.</p> <p>GVJ vlerëson se megjithëse nuk është program studimi i dedikuar për profesionet e rregulluara, programi i studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” i UE u mundëson studentëve ndjekjen e kualifikimeve profesionale të parashikuara nga kuadri ligjor vendas për marrjen e licencës së profesioneve të lira në fushën e financës.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Doc. shtesë Tabela e Ndryshimeve të Kurrikulës.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).</p>	

Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UE angazhohet dhe mbështetet personelin akademik në realizimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore si dhe garanton bashkëpunimin mes strukturave të tij në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. - Personeli akademik dhe studentët e këtij programi studimi angazhohen në aktivitete shkencore dhe projekte kërkimore në nivel institucioni si trajnime dhe leksione të hapura me specialistë të fushës, konferenca studentore dhe ndërkombëtare, projekte të Erasmus + etj. 		
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues rezultoi se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” pranë Universitetit EPOKA (UE) janë leksionet, ushtrimet, detyrat, projektet dhe rastet studimore. Gjithashtu, konstatohet se institucioni nxit edhe zhvillimin e leksioneve të hapura me specialistë të fushës.</p> <p>Plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin gjatë 2 viteve akademike të 3'000 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 576 orë mësimore në auditor leksione; ▪ 48 orë mësimore në auditor për temën e diplomës; ▪ 2'376 orë punë e individuale jashtë auditorit. <p>Në syllabusin e çdo lënde është i përfshirë informacioni në lidhje me numrin e orëve të leksioneve, detyrave, projekteve apo rasteve studimore. Në syllabus është e përcaktuar edhe mënyra e vlerësimit të studentëve me pikë (në %), si dhe detyrimi për frekuentim të lëndës. GVJ konstaton se mënyra e vlerësimit nuk është e harmonizuar mes lëndëve dhe në disa raste në syllabus mungon informacioni lidhur me detyrimin për frekuentimin e lëndës.</p>

	<i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Shtojca Nr. 86 Tabelat Përmbledhëse RVB M.Sc. në BAF.pdf; Doc. shtesë Tabela e Ndryshimeve të Kurrikulës.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	<p>Nga vizita në institucion GVJ mori konfirmimin se personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta dhe pa dallime diskriminuese, për të gjithë studentët në arritjen e objektivave të tyre akademike.</p> <p>Gjithashtu studentët konfirmuan se personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe nxit përfshirjen aktive të studentëve në procesin mësimor përmes projekteve dhe detyrave të kursit, vizitave mësimore në institucione, integritet të teknologjisë në mësimdhënie, si dhe përmes përpjekjeve për të përmirësuar programin e studimit në bazë të reaguesve dhe opinionëve të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; vizita në institucion]</i></p>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson angazhimin e UE në mbështetjen e personelit akademik për plotësimin dhe përmirësimin e kompetencave didaktike përmes organizimit të trajnimeve dhe leksioneve të hapura për personelin akademik në institucion, mbështetjes me fonde të veçanta për pjesëmarrje në trajnime dhe konferenca jashtë institucionit si dhe përmes hartimit të udhëzuesve dhe manualeve në ndihmë të organizimit të mësimin dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 27. EPOKA University Directive "On Academic and Administrative Performance Assessment and Quality Improvement".pdf; Annex No. 93. List of Staff Trainings.pdf; Annex No. 75. EIS Guideline Lecturer.pdf; vizita në institucion]</i></p>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe jetëshkrimeve të personelit akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit "Master i Shkencave në Financë-Bankë" përmbush kërkesat ligjore në fuqi për mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve pasi ka kualifikimin dhe kompetencat e duhura për shpjegimin e njohurive.</p> <p>Siç u përmend edhe më sipër, gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin nga studentët se personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe nxit përfshirjen aktive të studentëve në procesin mësimor përmes projekteve dhe detyrave të kursit, integritet të teknologjisë në mësimdhënie, si dhe përmes përpjekjeve për të përmirësuar programin e studimit në bazë të reaguesve dhe opinionëve të studentëve. Gjithashtu kuadri rregullator i institucionit parashikon rolin e Këshilltarit Akademik të studentëve (personel akademik i DFB sipas viteve të programit të studimit), si një element shtesë për të garantuar mbikëqyrje, mbështetje dhe këshillim të dedikuar për</p>

	<p>studentët gjatë procesit mësimor dhe aktiviteteve të tjera bashkëshoqëruese deri në diplomim.</p> <p>[Referenca: Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Annex No. 7. The CVs of the Academic Staff engaged in the MSc BAF.pdf; Annex No. 88. EPOKA University Open Lecture Assessment Form.pdf; Annex No. 89. EPOKA University Teaching Assessment Form.pdf; Annex No. 90. EPOKA University Quality Policy.pdf; Annex No. 98. Course Instructor Evaluation Surveys for Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, drejtuesi dhe personeli akademik i Departamentit Financë-Bankë konfirmuan se në fund të çdo viti akademik analizohet procesi mësimor dhe pjesë e kësaj analize janë edhe metodat e mësimdhënies. Gjithashtu GVJ mori konfirmimin se personeli akademik nxiti studentët gjatë orëve të mësimit të përfshihen sa më shumë edhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, duke ofruar sugjerime në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit kryesisht përmes anketave të vlerësimit në fund të çdo semestri, para provimit final të lëndës. Rezultatet e anketave analizohen në nivel departamenti por edhe në të gjitha strukturat drejtuese të UE, si pjesë e analizave vjetore, si dhe hartohen plane veprimi me qëllim përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në institucion.</p> <p>[Referenca: Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Annex No. 7. The CVs of the Academic Staff engaged in the MSc BAF.pdf; Annex No. 88. EPOKA University Open Lecture Assessment Form.pdf; Annex No. 89. EPOKA University Teaching Assessment Form.pdf; Annex No. 90. EPOKA University Quality Policy.pdf; Annex No. 98. Course Instructor Evaluation Surveys for Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe kuadrin rregullator të UE, GVJ vlerëson se në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar stuktura të posaçme e të pavaruara si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSC); dhe ▪ Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC). <p>që promovojnë dhe monitorojnë cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim edhe me njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC), strukturë e pavaruar e përhershme, përbëhet nga 11 anëtarë (nga një anëtar nga personeli akademik i çdo njësie kryesore të UE, dy përfaqësues nga personeli administrativ, një përfaqësues nga komuniteti i të diplomuarave të UE, një specialist i jashtëm me përvojë në vlerësimin e cilësisë në IAL dhe një anëtar nga këshilli studentor) të miratuar nga Senati i UE për një mandat 2 (dy) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.</p>

	<p>KSSC është përgjegjës për hartimin, planifikimin dhe bashkërendimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë në nivel institucioni në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.</p> <p>Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC) është strukturë në varësi të KSSC dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore mbështetur në standardet e sigurimit të cilësisë sipas kuadrit rregullator në fuqi. Gjithashtu kjo zyrë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të UE, si dhe në fund të çdo semestri organizon anketën e studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni mbështet personelin akademik në kualifikimin e vijueshëm me objektiv përmirësimin dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies përmes aplikimit në mobilitete Erasmus, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve në revista shkencore vendase dhe të huaja, si dhe përfshirjes në projekte të ndryshme kërkimore pranë UE.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se personeli akademik raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë mësimdhënëse, kërkimore dhe administrative. Ky informacion i përpunuar më pas nga strukturat përkatëse në formën e raporteve në nivel institucioni, bëhet pjesë e analizës vjetore të departamentit, ku mes të tjerash diskutohen efektet dhe problematikat e ndeshura gjatë përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>[Referenca: PSEER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 25. EPOKA University Policy: "On Continuous Improvement of Study Program".pdf; Annex No. 40. Regulation "On the Organization and Functioning of the Permanent Commission on Quality Assurance".pdf; Doc. shtesë Plani Strategjik për Vitet Akademike, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.pdf; Raporti i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë.pdf; vizita në institucion]</p>				
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në këtë program studimi janë të larmishme dhe në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. - Personeli akademik i programit të studimit është i angazhuar në përditësimin dhe përmirësimin e syllabuseve të lëndëve të këtij programi, si dhe teknikave dhe metodave inovative të mësimdhënies. - Personeli akademik i këtij programi studimi përmbush kërkesat ligjore në fuqi për mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve. - UE angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. 				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="558 1854 758 1930">Në përmbushje</td> <td data-bbox="758 1854 949 1930">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="949 1854 1157 1930">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1157 1854 1402 1930">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e UE dhe Rregullorja e FSHEA , përcaktojnë kriteret e vlerësimit të njohurive të marra nga studentët gjatë ciklit të studimeve bazuar në sistemin e vlerësimit me pikë (dhe shkronja) dhe me notë (kapitulli 7 i secilës rregullore). Gjithashtu, në këto dokumenta përcaktohen në terma të përgjithshëm edhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve dhe njohurive si teste ndërmjetëse, detyra, ushtrime, projekte, pjesëmarrje aktive dhe provim në fund të semestrit. Në mënyrë më specifike mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve përcaktohen në syllabusin e çdo lënde dhe u bëhen të njohura studentëve në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Në faqen zyrtare në internet të institucionit gjendet i publikuar i gjithë kuadri rregullator i UE ndërsa në hapësirën e dedikuar për zyrën e regjistrimit gjendet informacion specifik që i referohet sistemit të kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të studentëve.</p> <p>[Referenca: Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. shtesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; https://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html]</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët, që në fillim të semestrit, njihen me të gjithë elementët e programit mësimor (syllabusit) përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve nga pedagogu i lëndës.</p> <p>[Referenca: PSEER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Kuadri rregullator parashikon si forma të kontrollit dhe vlerësimit të nivelit të njohurive që studenti ka përvetësuar gjatë aktivitetit mësimor testimin e ndërmjetëm, detyrat dhe projektet e kursit, prezantimet, pjesëmarrjen aktive, provimin e lëndës dhe temën e diplomës.</p> <p>Nga shqyrtimi i programeve mësimore (syllabuseve), GVJ krijoi bindjen se vlerësimi i studentëve realizohet në bazë të formave të parashikuara në kuadrin rregullator, duke u dhënë mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>[Referenca: Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator i UE parashikon kritere dhe mënyra testimi të kombinuara lidhur me vlerësimin e dijeve të marra prej studentëve.</i> - <i>Studentët informohen që në fillim të semestrit nga personeli akademik dhe syllabuset e lëndës lidhur me kriteret dhe mënyrat e testimit të njohurive.</i> - <i>UE mundëson përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me objektivat formuese të programit të studimit.</i> 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi realizohet sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të UE.</p> <p>Konkretisht, kontrolli dhe vlerësimi i dijeve dhe njohurive të marra nga studentët realizohet në mënyrë të vazhdueshme përmes testeve ndërmjetëse, detyrave, ushtrimeve, projekteve, pjesëmarrjes aktive dhe provimit në fund të semestrit.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi GVJ konstatoi se vlerësimi i njohurive të studentëve ishte specifik për çdo lëndë dhe jo i harmonizuar përsa i takon përfshirjes së elementëve si pjesëmarrje aktive, teste, raste studimore, detyra dhe projekte kurse apo provimi në fund të semestrit.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ nuk konstatoi përdorimin e ndonjë sistemi elektronik testimi në funksion të këtij programi studimi përveç përdorimit të platformës interaktive SIE, e cila i mundëson institucionit menaxhimin e informacionit lidhur me proceset mësimore dhe administrative.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion me personelin akademik dhe studentë të programit të studimit, GVJ mori konfirmimin se vlerësimi përfundimtar i secilës lëndë të planit mësimor realizohet në përputhje me parashikimet në syllabusin përkatës dhe kuadrin rregullator të UE.</p> <p>Provimet zhvillohen me shkrim dhe me procedurë kodimi të gjeneruar nga SIE, në të cilën angazhohet edhe Koordinatorin i Departamentit Financë-Bankë. Gjithashtu, për të garantuar cilësinë e procesit të</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

36

<p>për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>provimit, në nivel institucioni me vendim të Sentatit të UE është ngritur dhe funksion Bordi i Provimit, i cili ndër aktivitetet kryesore ka edhe monitorimin e zbatimit cilësor të kuadrit rregullator lidhur me procesin e provimit.</p> <p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori edhe konfirmimin se në UE, bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare, si edhe i provimeve të ndërmjetme, i detyrave dhe projekteve të kursit, duke u dhënë studentëve këshilla në funksion të përmirësimit të punës së tyre në të ardhmen.</p> <p><i>[Referenca: PSEER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 32. Decision of the Rectorate of EPOKA University No. 04, dated 05.11.2019, Exam Anonymity.pdf; Annex No. 33. Exam Anonymity Process.pdf; Annex No. 34. Directive of EPOKA University "On the Functioning of the Exam Board".pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën.</p> <p>Kuadri rregullator i UE, e në mënyrë më specifike "Rregullorja mbi Disiplinën e Studentëve" dhe udhëzuesi "Për Provimet", parashikon përgjegjësitë edhe masat disiplinore në rastet e konstatimit të sjelljeve të dënueshme si kopjimi në provime, plagjiatura në punime shkencore, shkeljet e rregullave, etj. Kërkesat e Kodit të Etikës janë përfshirë edhe në programet mësimore (syllabuset).</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Annex No. 30. EPOKA University Guideline "On Examinations".pdf; Annex No. 31. EPOKA University Regulation "On Student Discipline".pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në UE bëhet një korrigjim i kujdesshëm dhe në kohë i provimeve.</p> <p>Komunikimi i rezultateve të provimit përfundimtar bëhet përmes sistemit SIE brenda pesë ditëve nga data e zhvillimit të provimit dhe dorëzimi i dosjes së plotë të provimit (fletët e provimit, teza, zgjidhja & rezultatet) bëhet pranë koordinatorit të departamentit brenda 10 ditëve. GVJ vlerëson se në UE përdoren instrumenta efektivë për të garantuar rezultate të bazuara mbi meritat e punës së studentit.</p> <p><i>[Referenca: PSEER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut,</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e UE (neni 51) dhe Rregullorja e FSHEA (neni 65) parashikon të drejtën e ankimit ndaj rezultatit në provim për të gjithë studentët, kundrejt depozitimit të një kërkesë për ankim pranë Sekretarisë Mësimore brenda pesë ditëve nga komunikimi i</p>

rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	rezultateteve të provimit. Ankesa shqyrtohet nga pedagogu i lëndës dhe vendimi përfundimtar (brenda 15 ditëve nga ankesa) merret nga Dekanati i FSHEA pas propozimit të Departamentit lidhur me procedurën e verifikimit dhe rishikimit të vlerësimit sipas situatës.		
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në raste të problematikave të veçanta, Bordi i Provimit bën verifikimet e nevojshme lidhur me ankesën e studentit (neni 4 i rregullores përkatëse). Procedura e ankimimit është e përfshirë në Udhëzuesin për Studentin e UE dhe është e publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit. <i>GVJ konstatoi qe kuadri rregullator aktual i UE nuk parashikon në mënyrë specifike ruajtjen e praktikës së ankimimit, por në RVB theksohet se kjo detyrë realizohet nga Sekretaria Mësimore si strukturë administrative përgjegjëse për ndjekjen dhe arkivimin e çdo dokumenti që lidhet me studentët (neni 67 i rregullores së FSHEA).</i> [Referenca: Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 34. Directive of EPOKA University "On the Functioning of the Exam Board".pdf; Annex No. 96. Grade Appeal Form.pdf; https://epoka.edu.al/mat/student_guide/2022_2023.pdf , vizita në institucion]		
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi realizohet sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të UE. - Ue nuk përdor sisteme elektronike për vlerësimin e provimit të studentëve. - Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. - Kuadri rregullator i UE parashikon të drejtën e ankimimit ndaj rezultatit në provim dhe garanton një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm për të gjithë studentët.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Rregullorja e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë-Bankë" përcakton se objektivi i këtij programi është t'u ofrojë studentëve njohuri të thelluara teorike dhe praktike të fushës së financës dhe sektorit bankar, përmes aplikimit të zhvillimeve bashkëkohore në kërkim. Gjithashtu programi i studimit synon të nxisë kërkimin e aplikuar dhe thellimin e kufijve të njohjes në këtë fushë (neni 3 i Rregullores së programit të studimit).


	<p>GVJ vlerëson se kryesisht lëndët e përfshira në këtë program u mundësojnë studentëve marrjen e njohurive të thelluara në fushën e financës dhe sektorit bankar përmes disiplinave si menaxhimi bankar, menaxhimi i riskut, menaxhimi i portofolit dhe analiza e investimeve. Por siç u përmend edhe më herët (Fusha II, Standardi II.1), plani mësimor i programit të studimit nuk parashikon praktikë profesionale dhe asnjë lëndë në kategorinë D – lëndë plotësuese, ndërkohë që pesha e lëndëve me zgjedhje është e lartë, përtej kufijve të parashikuar nga kuadri rregullator në fuqi dhe një organizim jo tipik për programet e studimit me natyrë të ngjashme.</p> <p><i>GVJ vlerëson se në kushtet aktuale lëndët e detyrueshme nga fusha e financës janë relativisht të kufizuara për të garantuar një thellim të njohurive në përputhje me profilin e programit të studimit, prandaj rekomandon rishikimin e planit mësimor lidhur me organizimin e lëndëve me zgjedhje dhe plotësimin me lëndë të detyrueshme në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator në fuqi dhe në funksion të fushës akademike të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit.</i></p> <p><i>[Referenca: Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. shitesë Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.pdf; Tabela e Ndryshimeve të Kurrikulës.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se përfshirja në planin mësimor të këtij programi studimi të lëndëve si “Metodat e Kërkimit në Ekonomi dhe Financë”, “Seritë Kohore në Ekonometri” dhe “Analizë financiare” u mundësojnë studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta edhe në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe analizës kritike. Por GVJ konstaton se plani mësimor i këtij programi studimi nuk parashikon realizimin e orëve të seminarit apo laboratorike të detyrueshme për asnjë lëndë.</p> <p><i>GVJ rekomandon që syllabuset e lëndëve duhet të rishihen dhe të reflektojnë aplikimin praktik të njohurive në orë seminari apo laboratorike të detyrueshme si dhe të shihet mundësia e përfshirjes së një lënde mbi sistemet e informacionit meqë programi nuk parashikon asnjë lëndë në kategorinë D (lëndë plotësuese).</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. shitesë Tabela e Ndryshimeve të Kurrikulës.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kompetencat dhe aftësitë e studentit në këtë program studimi vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë zhvillimit të programit mësimor nëpërmjet diskutimeve në leksione, realizimit të</p>




<p>rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>detyrave/projekteve të kursit, si edhe në përfundim të lëndës me provimin përfundimtar, i cili zhvillohet me shkrim.</p> <p>Gjithashtu, në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se në përfundim të çdo lënde, pedagogu përkatës informon studentët mbi vlerësimin e vazhdueshëm të fituar gjatë semestrit si dhe mbi strukturën e provimit dhe çështjet kryesore ku duhet të fokusohen për provimin përfundimtar.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 5. Curricula of the study program Master of Science in Banking and Finance.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Doc. shitesë Tabela e Ndryshimeve të Kurrikulës.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve GVJ konstaton se lëndët si “Metodat e Kërkimit në Ekonomi dhe Financë” dhe “Seritë Kohore në Ekonometri” u mundësojnë studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë. Por siç u theksua edhe më sipër, syllabuset përkatëse nuk parashikojnë orë seminari apo laboratorike të detyrueshme, pavarësisht se institucioni zotëron infrastrukturën e nevojshme për të mundësuar aktivitete të tilla.</p> <p>Gjithashtu, programi mësimor nuk përfshin praktikën profesionale si veprimtari mësimore e detyrueshme që do t'u mundësonte studentëve zhvillimin e aftësive profesionale përmes aplikimit të njohurive teorike të marra në auditor në një mjedis biznesi.</p> <p>Në takimin, gjatë vizitës në institucion, me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”, GVJ konstatoi se ata mbështesin dhe nxisin diskutimet kritike të studentëve brenda kuadrit të këtij program studimi. Syllabuset e lëndëve, të hartuara dhe zhvilluara prej tyre, nxisin bashkëpunimin dhe punën në grup të studentëve përmes detyrave dhe projekteve të kursit, prezantimeve të ndryshme dhe analizës së rasteve studimore dhe u mundësojnë studentëve pjesëmarrjen në mobilitete me institucionet me të cilat UE ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 6. Course Syllabuses of MSc BAF-compr.pdf; Annex No. 23. List of Students and Staff Mobility.pdf; Annex No. 24. List of Foreign Partnership Agreements.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin e personelit akademik të këtij programi studimi në leksione të hapura në bashkëpunim me profesionistë të ftuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Në Strategjinë e UE, ofrimi i një mjedisi cilësor për mësimdhënien dhe kërkimin & realizimin e projekteve përcaktohet si dy nga tre prioritetet e zhvillimit të institucionit në përputhje me vizionin e tij.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin e personelit akademik të këtij programi studimi në leksione të hapura në bashkëpunim me profesionistë të ftuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Në Strategjinë e UE, ofrimi i një mjedisi cilësor për mësimdhënien dhe kërkimin & realizimin e projekteve përcaktohet si dy nga tre prioritetet e zhvillimit të institucionit në përputhje me vizionin e tij.</p>

nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p>GVJ vlerëson angazhimin e UE për të zhvilluar standarde më të larta për punën kërkimore dhe zhvillimin e saj në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, si dhe për përfshirjen e studentëve në këtë proces përmes projekteve, punimeve të diplomës dhe pjesëmarrjes në konferenca me personelin akademik mbikëqyrës.</p> <p>Studentët janë të organizuar edhe në klube studentore si “Klubi i Financës”, veprimtaria e të cilëve mbështetet dhe nxitet nga institucioni.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Annex No. 63. Department Annual Report 2021-2022.pdf; https://epoka.edu.al/home-students-student-clubs-4-33.html; vizita në institucion]</p>		
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit garanton kryesisht marrjen e njohurive të thelluara dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në fushën e financës por duhet të rishihet plani mësimor lidhur me organizimin e lëndëve me zgjedhje dhe plotësimin me lëndë të detyrueshme në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator në fuqi dhe në funksion të fushës akademike të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit. - Programi i studimit u mundëson studentëve edhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, por plani mësimor i këtij programi studimi nuk parashikon realizimin e orëve të seminarit apo laboratorike të detyrueshme. - Personeli akademik nxit bashkëpunimin dhe punën në grup të studentëve, si dhe përfshirjen e tyre në projekte të ndryshme. - Pranë UE zhvillohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe mundësohet edhe përfshirja e studentëve në projekte të ndryshme, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes klubeve studentore të UE. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues konstatohet se plani mësimor i programit të studimit të “Master i Shkencave në Financë-Bankë” parashikon si detyrim përmbyllës diplomimin nëpërmjet mbrojtjes së temës së diplomës për të gjithë studentët.</p> <p>GVJ konstaton se parashikimet në kuadrin rregullator të UE lidhur me procedurën e diplomimit janë shumë të përgjithshme (neni 54 i Rregullores së FSHEA). Megjithatë në faqen zyrtare në internet të institucionit gjenden të publikuara informacione më specifike lidhur me këtë proces.</p>



	<p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; Annex No. 91. Master Thesis Form.pdf; Annex No. 92. Thesis Writing Guideline.pdf; https://epoka.edu.al/mat/Banking%20and%20finance/thesis-defense.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se këshlltari akademik dhe pedagogu i caktuar si mbikqyrës i temës së diplomës informojnë studentët mbi të gjithë procesin e diplomimit në programin master.</p> <p>Gjithashtu, institucioni vë në dispozicion të studentëve Udhëzuesin për Hartimin e Temës së Diplomës dhe formatet për procedurat e përgatitjes dhe të mbrojtjes së punimit të diplomës.</p> <p><i>GVJ konstaton se udhëzuesi me kërkesat për punimin e diplomës është i përbashkët për të tre ciklet e studimeve në UE dhe i përgjithshëm në kërkesa duke rrezikuar të mos bëjë dallimin e duhur mes cikleve dhe programeve të studimit, prandaj GVJ rekomandon rishikimin e tij dhe hartimin e një udhëzuesi në funksion të Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë.</i></p> <p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 91. Master Thesis Form.pdf; Annex No. 92. Thesis Writing Guideline.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblylës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”, parashikon punimin e diplomës si një lëndë e veçantë që zhvillohet në semestrin e katërt. Përmes komunikimeve të rregullta, pedagogu mbikqyrës i diplomës ndihmon studentin për përgatitjen e propozimit dhe platformës së temës së diplomës, i rekomandon për literaturën dhe burimet e tjera të informacionit që studenti duhet të hulumtojë në funksion të temës, si dhe vlerëson ecurinë e studentit deri në përfundimin e punimit. Nën koordinimin e Zyrës ICTC, biblioteka, laboratorët dhe ambiente të tjera të UE mund të shfrytëzohen nga studentët për studim të pavarur dhe për përgatitjen e temës dhe prezantimit të diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në takimet, gjatë vizitës në institucion, me studentët dhe personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”, GVJ konstatoi mbështetjen që studentët marrin nga personeli akademik përgjatë gjithë procesit të diplomimit.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 77. ICTC Office Services.pdf; Annex No. 91. Master Thesis Form.pdf; Annex No. 92. Thesis Writing Guideline.pdf; vizita në institucion]</p>

<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni përkatës në përfundim të mbrojtjes së diplomës bën vlerësimin e studentit me notë (deri në 10) dhe me pikë në përqindje (deri në 100) të parashikuar në kuadrin rregullator të UE. [Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; Annex No. 3. EPOKA University Basic Regulation.pdf; vizita në institucion]</p>		
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konstaton se në përfundim të studimeve në programin “Master i Shkencave në Financë-Bankë”, pasi studenti ka përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit, si dhe detyrimet financiare ndaj UE pajiset me diplomën përkatëse, suplementin e diplomës dhe listën e notave sipas modelit të miratuar. Diploma dhe suplementi i saj lëshohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, si dhe emërtohen në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studenti dhe me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Me kërkesë të studentëve vihet në dispozicion të tyre programi mësimor (syllabuset) për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit. [Referenca: Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 8. Regulation “On Second Cycle Study Programs”.pdf; Annex No. 35. Diploma Model.pdf; Annex No. 36. Diploma Supplement Model.pdf; Annex No. 37. Procedures on Students Records.pdf; vizita në institucion]</p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se pranë sekretarisë mësimore të UE ruhet i gjithë dokumentacioni mbi studentët, në formën e dosjeve personale dhe pas diplomimit në arkivën përkatëse bazuar në parimin e konfidentalitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 120 i Statutit të UE). Ky dokumentacion i vihet në dispozicion studentit me kërkesën e tij dhe mund të përdoret për konfirmime ndaj personave të autorizuar. [Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Annex No. 1 Statute of EPOKA (Albanian language).pdf; Annex No. 2. FEAS Regulation.pdf; vizita në institucion]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuadri rregullator i UE parashikon në terma të përgjithshëm procedurën e diplomimit dhe institucioni vë në dispozicion të studentëve udhëzues për procedurën e diplomimit. - Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në procesin e përgatitjes së punimit të diplomës. - Në përfundim të ciklit të studimeve, student vlerësohet me notë dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e saj. - Pranë UE dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. 		
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>			

Standardi III.6

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

43

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më 44cti të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	Ky Standard nuk zbatohet për këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e depozituar në sistemin AMS evidentohet se personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë”, ndërsa ka vend për përmirësim në fushën e tyre kërkimore për të qënë plotësisht në përputhje me programin e studimit. Departamenti Financë-Bankë që mbulon programin e studimit në akreditim ka pesë profesorë që mbajnë titullin Doktor si staf me kohë të plotë dhe disa prej tyre janë lektorë në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” .</p> <p>[Referenca: Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë”; RVB; Aneksi Nr. 79 – Kontrata e Punës Individuale e Stafit Administrativ; Aneksi Nr. 78 – Kontrata e Punës Individuale të Stafit Mësimdhënës; Tabelat përmbledhëse; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv është e lartë në vlerësimin tonë, pasi ngarkesa e tyre është mesatarisht mbi 330 orë mësimore në një vit akademik, duke nisur nga 224 orë për përgjegjësin e departamentit deri në 432 orë për një PAE në Departamentin Financë-Bankë.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Tabelat përmbledhëse; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UE është përpjekur të garantojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, por nga të dhënat në evidencat e ndryshme sidomos ato për stafin akademik efektiv të angazhuar pranë këtij programi studimi në vitet që po analizojmë, si edhe gjatë takimeve të kryera në vizitën pranë IAL. Nga vizita në BNJ evidentuam se kontratat e punës ishin të përkohëshme ose të përhershme (me afat të pacaktuar në kohë për PAE me grada e tituj shkencor). Kontratat e punës ishin të rregulluara sipas kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p>[Referenca: Ligji nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”; PSER_MSc BAF_shqip.pdf; Aneksi Nr. 78 – Kontrata e Punës Individuale të Stafit Mësimdhënës; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e brendshme “Për rekrutimin e stafit” të UE gjenden të pasqyruara kritere të përgjithshme dhe ato të veçanta për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. Në këto kritere nuk përfshihet nota mesatare e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Në këto kritere përfshihen përvoja e punës në mësimdhënie, kualifikime brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj. Të gjitha këto kritere shoqërohen me pikët respektive për procesin e vlerësimit që kryhet nga komisioni Ad-hoc.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit</p>	<p>Sipas RVB-së, procedurat e rekrutimit të stafit në UE rregullohen me Rregulloren e brendshme “Për rekrutimin e stafit” të UE dhe në</p>

<p>ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>përputhje me Statutin e Universitetit, por GVJ nuk evidenton referenca të drejtpërdrejta të statutit në këtë rregullore, si edhe GVB nuk ka dhënë asnjë referencë të drejtëpërdrejtë të statutit në përgjigjet për kriteret në RVB.</p> <p>Para fillimit të vitit të ri akademik bazuar në nevojat e Departamentit Financë-Bankë për PAE dhe PAK përcillet kërkesa për miratim në Bordin Administrativ. Është Zyra e Burimeve Njerëzore e cila procedon me hapat e mëtejshëm pasi vendoset miratimi për pozicione vakant nga Bordi Administrativ. Procesi i rekrutimit të personelit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. ZBNJ shpall pozicionin vakant në faqen zyrtare të internetit apo agjenci të tjera ndërkombëtare për rekrutim pune me kriteret e parashikuara në Rregulloren e UE “Për rekrutim të Stafit Akademik”. Aplikimet shqyrtohen nga Komiteti Shkencor që merr vendimin për aplikimin dhe ia transmeton këtë vendim Rektoratit nëpërmjet Dekanit të Fakultetit. Orët laboratorike dhe empirike zhvillohen në klasa 46ire46n duke përfshirë tabela inteligjente, kompjuterë me klasa të aksesueshme në internet për studime dhe kërkime empirike në nivelin master.</p> <p><i>GVJ referuar të gjitha sa më sipër evidenton se rregullorja për rekrutimin ka mungesë të përputhjes me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, pasi nuk ka të përcaktuar si kriter të detyrueshëm nivelin minimal të notës mesatare për studimet bachelor dhe master të stafit akademik pa grada shkencore apo tituj.</i></p> <p><i>[Referenca: Aneksit Nr. 7 – CV-të e Stafit Akademik; Aneksi Nr. 15 – Rregullorja e Universitetit EPOKA “Për Rekrutimin e Stafit”; RVB; Aneksi Nr. 85 – Shembull përshkrimi i vendit të lirë të punës; Aneksi Nr. 88 Formulari i Vlerësimit të Mësimdhënies; Aneksi Nr. 16 “Formulari i Rekrutimit të Stafit Administrativ të Universitetit EPOKA”; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Sipas RVB ruajtja e të dhënave të stafit organizohet duke mbajtur një skedar fizik personal për secilin anëtar të stafit të UE dhe përveç kësaj duke mbajtur një skedar elektronik në Sistemin Interaktiv të Epokës, që përditësohet në bazë të informacionit të paraqitur pranë BNJ nga çdo anëtar i stafit të UE, në fillimin e punësimit të tyre si personel akademik me kohë të plotë ose të pjesshme.</p> <p>Në praktikat më të fundit të rekrutimit të PAE-ve të verifikuar gjatë vizitës në IAL, u evidentua se kishim rastin e rekrutimit të një PAE me shtetësi të huaj për të cilën nuk ishte marrë ende njohja e gradës/titullit akademik nga MAS.</p> <p>UE për publikun përcjell imazhin e një IAL-je të konsoliduar dhe si e tillë duhet të kujdeset të rekrutojë vetëm staf akademik me grada shkencore dhe tituj akademikë të njohur nga Ministria përgjegjëse në Shqipëri.</p>

	<p><i>Rekomandohet IAL-së:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të plotësojë kriteret e rekrutimit me kriterin e notës mesatare të studimeve Bachelor e MSC për PAE/PAK pa grada shkencore apo tituj; ▪ të bëhet azhurnimi në kohë i dosjeve me kriteret ligjore të detyruara si njohja/ekuivalentimi i gradave shkencore apo titujve akademikë nga MAS, në të kundërt të merren masat për rekrutime të PAE në përputhje me kriteret ligjore. <p>[Referenca: Aneksit Nr. 7 – CV-të e Stafit Akademik; Aneksi Nr. 15 – Rregullorja e Universitetit EPOKA “Për Rekrutimin e Stafit”; RVB; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni tregon një sërë marrëveshjesh të nënshkuara me biznese të ndryshme me qëllim kryerjen e praktikave mësimore. GVJ, gjatë vizitës në Institucion konfirmoi me studentët mënyrën e instruktimit dhe udhëheqjes së tyre gjatë procesit të përgatitjes së diplomës, por jo të praktikës profesionale pasi nuk e kanë pjesë të planit mësimor. Në lidhje me punimin e temës së diplomës Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar të cilën e referon në Rregulloren Themelore. Sipas RVB, rregullorja për studimet e ciklit të dytë përcakton se drejtuesi i tezës (udhëheqësi shkencor) zgjidhet nga personeli akademik që zotëron të paktën titullin Doktor i Shkencave. Gjatë vizitës në Institucion GVJ u informua nga studentët pjesëmarrës në takim se një pjesë e vogël e studentëve të vitit të dytë kishin përfunduar punimin e diplomës, ndërsa pjesa tjetër e kishin zhvendosur atë për vitin e ardhshëm akademik. Udhëheqësit përcaktoheshin nga departamenti, ndërsa temat përcaktoheshin nga udhëheqësi. <i>Për këtë GVJ rekomandoi që temat e punimeve të diplomës të përcaktoheshin në bashkëpunim mes studentit dhe pedagogut udhëheqës.</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; Aneksi Nr. 8. Rregullorja: “Për Programet e Studimit të Ciklit të Dytë”; vizita në institucion]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Personeli Akademik Efektiv i përfshirë në këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë”, por ka vend për përmirësim në fushën e tyre kërkimore për të qënë plotësisht në përputhje me këtë program studimi. - Ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv është e lartë në vlerësimin tonë, pasi ngarkesa e tyre është mesatarisht mbi 330 orë mësimore në auditor një vit akademik, duke nisur nga 224 orë për përgjegjësin e departamentit deri në 432 orë për një PAE në Departamentin Financë Bankë. Kjo ngarkesë mund të pengojë angazhimin e tyre në kërkim shkencor.

	<p>- Pranë UE ka një lëvizje relativisht të lartë të personelit akademik efektiv.</p> <p>- Rregullorja e rekrutimit të UE nuk parashikon si kriter të detyrueshëm nivelin minimal të mesatares për studimet bachelor dhe master të stafit akademik pa grada shkencore apo tituj dhe një dosje PAE ishte ende në proces ekuivalentimi të gradës shkencore/ titullit akademik nga MAS.</p> <p>- UE mbështet dhe udhëheq studentët në përgatitjen e punimit të diplomës por jo të praktikës profesionale pasi nuk e kanë pjesë të planit mësimor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ nga vlerësimi i infomacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në IAL evidenton se, UE ka krijuar mjediset dhe mundësi shumë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”. Klasat ishin të pajisura me mjete dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e orëve mësimore. Në mjediset e IAL-së nuk mungonte sistemi wireless i aksesueshëm për studentët për tu përdorë prej tyre në webs të nevojshëm për kërkim në funksion të procesit mësimor. Sipas RVB, Fakulteti i Ekonomisë dhe Shkencave Administrative ka në përdorim pesë auditore, një sallë konferencash për leksione dhe 8 klasa për seminare.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	[Referenca: Aneksi nr. 73 “Infrastruktura në shërbim të programeve të studimit...”; Aneksi nr. 65 “Informacion mbi kapacitetet infrastrukturore”; PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 3. Laboratorët, 48ctive, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	UE për këtë program studimi nuk ka aparatura specifike pasi natyra e programit nuk ja ka kërkuar ende të tilla, por në dispozicion të orëve aplikative të mësimin ata shprehen se kanë dy laboratorë të paisur me programe të përshtatura me lëndët e këtij programi studimi duke përdorur programe statistikore softuerike si Stata, E-views, R program dhe tre laboratorë informatikë ku janë të instaluar edhe MS Office, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 i fundit, Multisim 11, VMware workstation, MySQL \ Workbench, Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + -MAX, SPSS, Eviews, etj.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të	

<p>teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ, referuar RVB-së dhe konstatimit nga vizitat në institucion, shprehet se IAL disponon laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës specifike të disa prej lëndëve të planit mësimor të programit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” .</p> <p>[Referenca: PSEK_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Shtojca Nr. 86 – Tabelat Përmbledhëse/ Tabela Nr. 16 “Objektet e Fakultetit/ Njësitë Bazë”; Annex No. 66 – Capacity Verification Report 2022-2023; Annex No. 73 – Infrastructure in Service to study Programs, Logistics and other Services towards Community]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>GVJ referuar RVB-së dhe konstatimit nga vizitat në institucion shprehet se lidhur me praktikën profesionale ky program studimi nuk e ka ende atë të detyruar në planin e tij mësimor. Ky detyrim do të fillojë nga viti II ardhshëm akademik sipas përgjigjeve të dhëna nga stafi IAL-së gjatë vizitës në institucion. Për mosplotësimin të këtij kriteri, GVJ është shprehur në një tjetër fushë të këtij raporti.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UE ka krijuar mjedise dhe mundësi shumë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”. - Klasat e leksioneve dhe të seminareve dhe ambientet e tjera janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një proces mësimor bashkëkohor. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimdhënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se ofrohen tituj të mjaftueshëm në literaturën bazë dhe ndihmëse të vënë në dispozicion të studentëve dhe se këto tituj ishin në gjuhën angleze. Bazuar në bisedat me stafin pedagogjik, tekstet mësimore siguroheshin nga marrëveshjet që Institucioni ka me shtëpi të ndryshme botuese. Të pyetur gjatë vizitës</p>

parashikuara në programin e studimit.	në Institucion, studentët konfirmuan se literatura është në gjuhën angleze dhe se u vihet në dispozicion në biblioteka online apo fizikisht. [Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 6 "Course Syllabuses"]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia përgjegjëse që në këtë rast është Departamenti Financë-Bankë, në çdo fund viti akademik kujdeset për rishikimin e syllabuseve dhe nëse ka propozime e ndryshime të miratuara për përmirësime të nevojshme në lëndë të caktuara. Pas kësaj ky departament raporton mbi përditësimet e nevojshme të literaturës me botime të viteve të fundit. [Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 25 "Politika e Universitetit EPOKA"]
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas RVB, biblioteka e UE është në dispozicion për të gjithë studentët bachelor / master / doktorantë, akademikë dhe staf administrativ me kapacitetin e saj 100-vendësh, sipërfaqe prej 400 metrash katrorë, 25000 libra të shtypur dhe 2000 revista akademike digjitale, e cila pasurohet vazhdimisht bazuar në kërkesat e stafit dhe studentëve. [Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 70 – List of books or periodicals in the Library; Annex No. 71 – List of Books newly added in the Library]
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, 50 aktive 50 tra ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas RVB, kjo IAL u siguron stafit akademik dhe studentëve akses në një gamë të gjerë të revistave shkencore si: baza e të dhënave JSTOR, Cambridge Journals Online, IOPscience, New England Journal of Medicine, OECD-iLibrary, Taylor dhe Francis Library. Literatura e bibliotekës në gjuhë të huaj për çdo vit ka shtesa në tituj përmes blerjeve dhe dhurimeve të literaturës. [Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 70 – List of books or periodicals in the Library.]
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	IAL ju mundëson të gjithë studentëve të këtij programi akses në literaturë përmes lidhjes në linkun ¹ http://lib.EPOKA.edu.al/ , si edhe tek JSTOR ² etj., ku mund të gjendet literaturë e mjaftueshme në gjuhë të huaj për fushën e studimit "Master i Shkencave në Financë-Bankë". Ky akses mundësohet pa pagesë dhe në mënyrë të barabartë për çdo student të UE përmes adresës personale të çdo student të UE.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ, gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës ku zakonisht shkojnë studentët dhe stafi akademik i këtij programi, evidentoi se biblioteka ishte e pajisur me kompjutera dhe akses në internet dhe kushte kondicionimi dhe aspirimi, pasi është e lidhur me ambientet e përgjithshme të Kampusit. [Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf B; vizita në institucion.]
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në	GVJ u bë me dije se biblioteka e përdorur nga studentët e këtij programi është e hapur për studentët nga e Hëna në të Premte sipas orareve 08:30

¹ <http://lib.epoka.edu.al/>

² <http://www.jstor.org/>

orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	– 12:30 dhe 13:30 – 19:30. Ndërsa ditën e Shtunë është e hapur nga ora 09:00 deri në orën 13:00.		
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB rezulton se personi përgjegjës i bibliotekës në bashkëpunim me Departamentin Financë-Bankë, si njësi përgjegjëse e këtij programi studimi ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, duke mundësuar që koleksioni i bibliotekës të pasurohet sipas kërkesave të stafit dhe studentëve të këtij programi. Biblioteka ka një program të veçantë, i cili përfshin check-in dhe check-out dhe raporte të ndryshme të lëvizjes së titujve. Biblioteka funksionon në një sistem rafti të hapur, duke u mundësuar përdoruesve të arrijnë drejtpërdrejt te librat. [Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 72 – Library Services]		
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Literatura bazë dhe ndihmëse e programit përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. - Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim optimal në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të UE. - Institucioni angazhohet në përditësimin e fondit të bibliotekës (fizik dhe online) si dhe shkallën e shfrytëzimit të saj.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstatohet se Sistemi Interaktiv EPOKA (EIS) është sistemi kryesor i brendshëm i administrimit institucional. EIS përmban informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë	


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

51

<p>informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit 52ctive52trative dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Meqënëse EIS është zhvilluar së brendshmi për të menaxhuar të gjitha informacionet, që lidhen me studentët dhe veprimtarinë e tyre nga viti i parë i regjistrimit deri në diplomimin e tyre, nga GVJ u kërkua certifikimi i sigurisë së këtij sistemi dhe kush kujdeset për auditimin e tij dhe ku ruhen të dhënat në rast të një situatë krize. Përgjigjet e marra nuk arritën të ezaurojnë çështjet e ngritura.</p> <p><i>GVJ i rekomandon IAL-së:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të marrë masa për certifikimin e sigurisë së EIS si edhe ta vendosë në planet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm këtë veprimtari; ▪ të krijojë plane rikuperimi dhe ruajtjeje të të dhënave të sistemit në raste katastrofash. <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 75 "EIS Guideline -Lecturer"; Annex No. 76 "EIS Guideline – Student"; Annex No. 77 "ICTC Office Services"]</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB-së, EIS është një sistem interaktiv online i përdorshëm nga çdo student apo i punësuar pranë UE përmes regjistrimit të llogarisë zyrtare të tyre në UE. Në EIS, studentët mund të përdorin informacionin e tyre personal dhe informacionin në lidhje me programin e tyre të studimit. Po ashtu edhe PAE dhe PAK kanë akses në lëndët e tyre. Staf i administrativ dhe ndihmës si administratorët e fakulteteve, zyra e BNJ dhe ajo e Financës, si edhe zyrat e pranimeve, e regjistrimit etj., kanë të drejtat e tyre dhe fushat përkatëse për akses në EIS për të menaxhuar dokumentet e studentëve, stafit dhe informacione të tjera të nevojshme.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Përmes EIS, studentët mund të hyjnë në kurrikulën e programit, transkriptin, kërkesat dhe njoftimet e dhëna nga pedagogët apo stafi administrativ. Pedagogët mund të përditësojnë programet e lëndëve, frekuentimin e studentëve, të caktojnë dhe të finalizojnë notat në sistem etj.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e 52ctive52trative dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Gjithashtu sipas RVB-së, Sistemi i Menaxhimit të Mësimit (LMS) - është një tjetër sistem shërbim, i bazuar në Moodle, i ofruar për studentët dhe pedagogët me qëllim aksesin, koordinimin dhe organizimin e materialeve të lëndës në internet.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p><i>GVJ konstaton se informacioni që lidhet me këtë program studimi, personelin akademik të DFB dhe aktivitetet e ndryshme të tyre janë të publikuara vetëm në anglisht në faqen e internetit, pavarësisht se është shtuar edhe butoni në shqip, përsëri informacioni edhe aty gjendet vetëm në anglisht. GVJ rekomandon të merren masa urgjente për publikimin në shqip të të gjithë informacioneve që lidhen me këtë program studimi, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme që kryhen nga DFB dhe studentët e këtij programi studimi.</i></p> <p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se UE është ende duke punuar me faqen zyrtare të internetit për të vënë në dispozicion informacionin e plotë edhe në Gjuhën Shqipe.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion]</i></p>

Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UE përdor platformën EIS për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë institucionit. - EIS është i zhvilluar nga vetë institucioni dhe ka nevojë për certifikimin e sigurisë nga ekspertë të pavaruar, si dhe përfshirjen në planet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si veprimtari. - Informacioni që lidhet me këtë program studimi, personelin akademik të DFB dhe aktivitetet e ndryshme të tyre janë të publikuara vetëm në anglisht në faqen zyrtare të internetit. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>GVB lidhur me këto kritere nuk ka të evidentuar sesa janë kostot në shifra për këtë program studimi dhe planin për mbështetjen e tyre. Gjithashtu, GVB në përgjigje të kritereve të kësaj fushe nuk ka sjellë evidenca zyrtare me shifra dhe fakte për të parë plotësimin e kritereve të këtij standardi. Në RVB, në evidencat e depozituara në sistemin e ASCAL por edhe gjatë vizitës në IAL nuk u shprehën nëse UE harton një raport financiar të kostove dhe një plan financiar të dedikuar për këtë program studimi, përveç se një table që përmbante vetëm të ardhurat dhe shpenzimet në total për këtë program studimi.</p>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	<p>Sipas RVB, Bordi Administrativ miraton buxhetin vjetor dhe afatmesëm të institucionit. Pas miratimit të nevojave dhe buxhetit, Zyra e Financës në bashkëpunim me Administratorin ndjek shpërndarjen dhe zbatimin e buxhetit.</p> <p><i>GVJ rekomandon, IAL të kryejë analizë të kostos së këtij programi studimi me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga tarifat e studentëve.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 87 "Data from the Annual Institutional financial report related to the cost of the study program"]</i></p>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim 53ctive53t, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	<p>Referuar RVB-së, nuk evidentohet që UE të ketë Njësi të Auditimit të Brendshëm në zbatim të nenit 116 të Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", por mbi këtë IAL aplikohet auditim vjetor i</p>

	<p>brendshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e “Turgut Ozal Education” sh.a. dhe jo nga vet Universiteti “EPOKA”.</p> <p>Gjirthashtu, referuar RVB-së “Turgut Ozal Education” sh.a. zhvillon një auditim të jashtëm vjetor në lidhje me situatën financiare të tij, por jo të Universitetit “EPOKA”.</p> <p>Sipas RVB-së, raporti i audituesit të jashtëm përmban të gjitha analizat e të dhënave mbi shpenzimet dhe të ardhurat e kompanisë dhe institucioneve të përfshira, të gjitha hyrjet që lidhen me të ardhurat (grante, tarifat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofrohen drejtpërdrejt ose indirekt nga kompanitë e jashtme, por vetëm një kopje e auditimit vjetor gjendet në Zyrën e Financave të Universitetit “EPOKA” dhe kjo kopje nuk është bërë e aksesueshme në RVB apo për GVJ-në.</p> <p><i>GVJ i rekomandon IAL-së ngritjen dhe vendosjen në funksionim të Departamentit të Auditimit të Brendshëm për këtë IAL, si edhe kryerjen dhe publikimin e raportit vjetor të auditimit të brendshëm për vetë Universitetin “EPOKA”, të veçantë nga ai i “Turgut Ozal Education” sh.a i cili është pjesë e detyrimeve ligjore për efekt të raportimit financiar të konsoliduar të grupit të biznesit.</i></p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Përgjigja e dhënë nga GVB nuk i jep përgjigje kriterit 4.</p> <p>GVJ bazuar në raportim e të ardhura shpenzimeve në total për këtë program studimi për 2018-2019 deri në 2021-2022 evidenton rritje në vlerë të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe në të njëjtën kohë nuk kemi të njëjtin ritëm rritjeje në vlerë për shpenzimet e stafit dhe kërkim zhvillimin. Kjo përjasje nuk ndihmon rritjen e cilësisë së studimit në këtë program studimi.</p>						
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>[Referenca: PSEER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 87 “Data from the Annual Institutional financial report related to the cost of the study program”]</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UE nuk bën një analizë të kostos së këtij programi studimi për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga tarifat e studentëve. - UE nuk ka një strukturë auditimi të brendshëm të dedikuar por auditohet nga jashtë si pjesë e grupit “Turgut Ozal Education” sh.a. 						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="561 1751 738 1816">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="745 1751 970 1816">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="976 1751 1185 1816">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="561 1825 738 1861"></td> <td data-bbox="745 1825 970 1861" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="976 1825 1185 1861"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UE është kujdesur të hartojë dhe zbatojë rregullore dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në Financë-Bankë”.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për 55ctive55 dhe studentët e programit të studimit.	Konkretisht, për pranimet në këtë cikël studimi, të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe të ndjekin procedurën e regjistrimit të publikuar në anglisht nga UE në http://admissions.epoka.edu.al/home-enrollment-procedure-1923-1925.html .
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të 55ctive55 shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Sipas RVB-së, UE në këtë program studimi pranon studentë vendas dhe të huaj në bazë të kuotave të studentëve të propozuara nga UE dhe të miratuara nga MAS. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe të ndjekin procedurat e regjistrimit. Për të regjistruar studentë cilësorë, UE jep bursa të bazuara në merita për më të mirët për të gjithë kohëzgjatjen normale të studimeve të tyre. Gjithashtu, ka bursa për: fëmijë të policivë të vrarë në krye të detyrës; jetimët vijnë nga familje me të ardhura të ulëta; studentë që i përkasin komunitetit rom/egjiptian; sportistë me rezultate të larta në kategorinë sportive olimpike përkatëse; nxënës nga bashkia Vorë.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në çdo vit akademik, UE i referohet urdhrin të QSHA dhe RASH për procedurat e regjistrimit të programeve të studimit të Ciklit të Dytë.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UE ka kuota të miratuara nga MAS për pranimin në këtë program studimi të kandidatëve nga vende të tjera. Ata duhet të plotësojnë kriteret e pranimit dhe të ndjekin procedurën e regjistrimit.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik	

<p>kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Për t'u evidentuar është edhe konstatimi i kryer në verifikimin e bërë në faqen web³ të UE-së ku gjenden të publikuara kriteret dhe procedurat që kanë të bëjnë me: pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit për cilindo prej studentëve që ndjek ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave në Financë-Bankë”. UE përmes projektit IDEA të financuar nga Erasmus+ krijon kushte të arsimit gjithëpërfshirës edhe për studentët me aftësi ndryshe apo me vështirësi në të nxënë.</p>		
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton se UE është kujdesur plotësisht për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve në programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në Financë-Bankë”.</p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>[Referenca: PSEr_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Aneksi nr.44 “Kuotat e pranimit për vitin akademik 2022-2023”; Aneksi Nr. 42 “Bursa për Programet Master”; Aneksi Nr. 8 “Rregullorja ‘Për Programet e Studimit të Ciklit të Dytë’”; Aneksi Nr. 2 “Rregullorja FEAS” Aneksi Nr. 43 “Ekipi i Aksesueshmërisë”; Aneksi Nr. 50 “Politika për Studentët me Aftësi të Kufizuara”; Annex No. 45 “Social Scholarships”]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UE është kujdesur plotësisht për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve në programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në Financë-Bankë”. - Kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve bëhen publike nga UE përpara fillimit të aplikimeve për pranimit në ciklin e studimeve master. - UE respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave, shtresave në nevojë dhe kandidatëve nga shtete të tjera. - UE respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me politikën e ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për studentët cilësorë 		
<p>Skalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe</p>	

³ <https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&dpid=2&t=master-of-science&catid=1928&menuid=1930>

<p>të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ ka evidentuar edhe më herët në këtë RVJ, se UE ka një praktikë për t'u vlerësuar pozitivisht përmes përdorimit të sistemit informativ EIS, i cili u mundëson studentëve akses të plotë mbi procedurat e përparimit akademik të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ konstaton se UE ka miratuar në rregulloret e tij si dhe në rregulloren e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve të mundshme nga kualifikimet e mëparshme ose studimet e pjesshme si edhe transferimin e tyre në këtë program mësimor. Konstatohet se të gjithë studentët e interesuar mund ta gjejnë lehtësisht këtë informacion në website të UE-së <i>me të vetmen vërejtje të evidentuar edhe më herët që kjo IAL kuadrin e saj rregullator e ka kryesisht në gjuhën angleze.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Konkretisht, u evidentua se në fillim të çdo viti akademik DFB ngre një komision ad-hoc për njohjen e lëndëve dhe krediteve respektive bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga sekretaria mësimore për studentët e interesuar.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL evidenton se DFB në çdo fillim semestri për çdo vit akademik shpall në ambiente publike orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për çdo semestër.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu, programi (syllabusi) i çdo lënde mësimore ka të përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve. Këto u prezantohen studentëve në orën e parë të mësimin nga pedagogu i lëndës. Gjithashtu, këto informacione studentët mund t'i marrin edhe përmes faqes zyrtare në internet të UE-së si edhe në sistemin EIS dhe pranë sekretarisë mësimore nëse do ta gjykojnë të nevojshme.</p> <p>GVJ konstaton se UE ka miratuar në rregulloren e tij, si edhe në rregulloren e këtij programi studimi, të gjitha kriteret e procedurat për kryerjen e punimit të diplomës dhe diplomimin në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 3, “Basic Regulation of EPOKA University”, Article 3; Annex No. 8 “Regulation ‘On Second Cycle Study Programs’”; Annex No. 67 “Student guide”; Annex No. 5 “Basic Regulation of EPOKA University”, Articles 31, 37, 59; Annex No. 47 “On Student Transfer”; Annex No. 48 “Example of a Decision on Student Transfer”]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UE vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”.

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Sipas RVB-së, para fillimit të çdo semestri, të gjithë pedagogëve u kërkohet të ngarkojnë në sistem programin lëndor (syllabusin), i cili përmban informacione rreth planit të studimit, metodës së vlerësimit dhe materialeve të lëndës. Të gjitha programet mësimore gjenden online ⁴ dhe janë të aksesueshme për studentët. Syllabuset e të gjitha lëndëve të programit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” mund të aksesohen përmes faqes zyrtare ⁵ të Departamentit Financë-Bankë.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ kontstaon se në DVV ka mospërputhje mes përgjigjes së RVB-së për kriterin 3 ku evidentohet se UE ka mbi 60 marrëveshje bashkëpunimi me organizata të ndryshme, ndërsa bashkëpunon me mbi 110 kompani të tjera për vende të lira pune dhe mundësi praktike ⁶ , ndërsa referuar Aneksit 24 në DVV konstatohen vetëm 15 marrëveshje të listuara me institucione dhe asnjë marrëveshje me biznese. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni organizon aktivitete të tilla si Forum i Hapur, Sesion Informativ, Vizita në Kompani, ngjarje të tjera si Panairi i Karrierës për mundësi punësimi etj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ, referuar RVB-së dhe vizitës në IAL evidenton, se UE ka aplikuar si praktikë të marrë nga Universitetet Turke një strukturë të quajtur Dekani i Studentëve, i cili është në varësi të Administratorit të IAL-së dhe përveç të tjerash ka në varësi edhe zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar (ZPKSD). Kjo zyrë, në bashkëpunim me Departamentin Financë-Bankë mban lidhje me organizatat publike dhe private dhe bizneset me qëllim orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Dekani i studentëve, përveçse kujdeset për orientimin dhe nevojat e studentëve në ambientet e tjera të kampusit, sëbashku me zyrat në varësi të tij, pret edhe shqetësimet e studentëve për aktivitete shkollore dhe kujdeset për zgjidhjen e tyre. <i>GVJ konstaton se nuk kuptohet deri në çfarë mase përgjegjësitë dhe kompetencat e Dekanit të Studentëve ndikojnë mbi veprimtarinë akademike të PAE dhe PAK si edhe drejtuesit</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në 58ctive58t.	

⁴ <https://eis.epoka.edu.al/curricula/87/program>

⁵ <https://baf.epoka.edu.al/home-m-sc-in-banking-and-finance-1761-227.html?lang=EN&dpid=2&t=m-sc-in-banking-and-finance&catid=1761&menuid=227>

⁶ <https://cpao.epoka.edu.al/event-information-session-united-nations-youth-association-albania-5040.html>, <https://cpao.epoka.edu.al/event-career-training-tuesday-june-16-2020-at-6-00-pm-5320.html>

	<p>e tyre, prandaj GVJ këshillon trajtimin me kujdes të ndarjes së kompetencave dhe influencave të Dekanit të Studentëve (i cili ka varësi të drejtëpërdrejtë nga administratori i IAL-së) nga veprimtaria akademike.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, studentët e pyetur nga GVJ lidhur me kriterin 5, të këtij standardi, u shprehën pozitivisht për aksesin në dhe mundësitë që UE u ka ofruar për t'u informuar lehtësisht edhe në distancë përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit EIS. Studentët kanë akses në informacionin e tyre personal dhe informacionin që lidhet me programin e tyre të studimit duke mundësuar regjistrimin e lëndës përmes sistemit, kontrollin e statusit të tyre akademik në lëndët e regjistruara gjatë semestrit, datat e provimeve, notat e ndërmjetme dhe notat përfundimtare. Përmes EIS, studentët shikonin kurrikulën e programit, transkriptet, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet etj.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 5 "curricula"; Annex No. 6 "Course Syllabuses"; Annex No. 76 "EIS Guideline Student"; Annex No. 67 "Student guide"]</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UE vë në dispozicion të studentëve të programit "Master i Shkencave në Financë-Bankë" informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. - Informimi në distancë realizohet edhe përmes faqes web zyrtare të UE dhe hapësirës së dedikuar në platformën EIS. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomimin, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL, kërkoi të verifikojë ato çfarë evidentoheshin në RVB, se sekretaria mësimore e DFK disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. GVJ konstatoi se të dhëna e cituara më sipër ruhen në formë të shkruar (hard copy) si dhe në formë elektronike.</p>

<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sipas DVV-së dhe vizitës në sekretarinë mësimore të IAL u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për pesë vitet e fundit akademike ishte si në vijim, por evidentohet rënia e madhe në vitin e fundit dhe për të cilën nuk kishte ende asnjë analizë nga Dekani studentëve apo strukturat e tjera përgjegjëse:</p>			
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Viti 2018-2019 33 studentë gjithsej, nga ku 4 të transferuar; - Viti 2019-2020 38 studentë gjithsej, nga ku 4 të transferuar; - Viti 2020-2021 38 studentë gjithsej, nga ku 1 të transferuar; - Viti 2021-2022 36 studentë gjithsej, nga ku 0 të transferuar; - Viti 2022-2023 10 studentë gjithsej, nga ku 0 të transferuar; 			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin 60ctive60t pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, 60ctive60t e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sekretaria kujdesej të zbatonte nenin 101 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/15 duke regjistruar arritjet akademike në formë të shkruar dhe elektronike të të gjithë studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi e deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Çdo vit akademik Zyra e Regjistrimit të paktën tre herë në vit raporton të dhëna statistikore pranë MAS për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë të braktisur dhe përfundimin me sukses të vitit akademik.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Përveç formës tradicionale të shkrimit në regjistrat përkatës, të dhënat statistikore të studentëve të programit mësimor të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në UE menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit EIS në formë elektronike. <i>GVJ është shprehur me rekomandim më herët në këtë raport lidhur me sigurinë dhe çertifikimin e sistemeve të informacionit të përdorur nga UE dhe ruajtjen e të dhënave në raste katastrofash.</i></p> <p>Sekretaria mësimore dhe zyrat e tjera, që kanë akses në këto të dhëna, kujdesen të ruajnë dhe përpunojnë të dhënat personale të studentëve bazuar në parimin e kofidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>			
	<p>[Referenca: PSEr_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 64 “Institutional Annual Report”; Annex No. 6 “Course Syllabuses”; Annex No. 76 “EIS Guideline Student”; Annex No. 67 “Student guide”]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UE mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. - Sekretaria mësimore dhe zyrat e tjera, që kanë akses në këto të dhëna, kujdesen të ruajnë dhe përpunojnë të dhënat në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




Paragrafi V.5

Udhëzimi i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, udhëzues të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kritere	Vlerësimi i ekspertëve
<p>ri 1. Institucioni parashikon miratimin dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Referuar RVB-së, UE ashtu si çdo IAL tjetër në zbatim të nenit 98 dhe 99 të Ligjit Nr. 80, 2015, dhe statutit të UE u garanton studentëve të drejtat të marrin pjesë në proceset e vendimmarrëse dhe këshilluese të UE-së.</p> <p>Konkretisht studentët e UE-së përfaqësohen në vendimmarrjen e strukturave drejtuese të UE përmes përfaqësuesit të tyre të zgjedhur bazuar në nenet 15, 16, 29, 34 dhe 35 të Statutit të Universitetit EPOKA për në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe në Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët. Përmes anëtarësimit të përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur në Senatin Akademik, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Këshillin e Etikës si dhe pjesëmarrjen aktive të këtyre përfaqësuesve të studentëve në mbledhjet e këtyre organeve sigurohet përfshirja e studentëve në vendimmarrjen e çështjeve që i përkasin procesit akademik.</p>
<p>ri 2. Institucioni duhet të sigurojë se përfshirja e studentëve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo miratimin mbi procesin akademik, këshillime reale, konkrete, frutdhënëse dhe rezultate lehtësisht të aksesueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata nuk njihnin përfaqësuesit e tyre në Bordin e Administrimit. Gjithashtu, ata nuk ishin shumë të informuar për të drejtat e përfaqësimit të tyre sipas statutit të UE në Senatin e UE apo Bordin e Administrimit.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 64 "Statute"]</p>
<p>ri 3. Njësia përgjegjëse duhet të sigurojë ton përfshirjen e studentëve në hartimin e programit të studimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe të sugjerimet e kontributin e studentëve të tyre dhe të tjerëve të mblodhur në mbledhjet e tyre, me anëtarë të grupit, komiteteve, grupet fokusimi, etj.</p>	<p>Sipas evidencave të depozituara në sistemin e ASCAL dhe RVB-së, hartimi i programit të studimit "Mastër i Shkencave në Financë-Bankë" është bërë në përputhje me bazën ligjore në fuqi për hapjen e programeve të Studimit, Udhëzimi i MAS Nr. 15, datë 04.04.2008. Ndryshimet, përmirësimet e këtij programi në vite janë bërë në referencë të ndryshimeve të bazës ligjore, por jo bazuar në ndonjë studim tregu.</p> <p>GVJ nuk konstatoi tek evidencat asnjë raport apo analizë për rishikim të programit të studimit në mbështetje të ndonjë propozimi nga studentët apo nga analiza e anketimit të tyre. Gjithashtu, gjatë vizitës GVJ konstatoi sipas komenteve të studentëve nevojën e shprehur prej tyre edhe më herët për lidhjen e teorisë me praktikën dhe realitetin në Shqipëri ku ata jetojnë dhe mund të punësohen.</p>
<p>ri 4. Studentëve u mundësohet të marrin pjesë në hartimin e mendimit mbi barazinë dhe përfshirjen e tyre në kryerjen e procesit të miratimit dhe kontrollit të dijeve, miratimit të burimeve, miratimit të ankimimit të studentëve, rishikimit dhe reflektimit të studentëve.</p>	

nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve të këtij programi studimi u mundësohej të kërkonin rishikim të vlerësimit (notës) së tyre brenda 1 jave përmes Zyrës së regjistrimit, e cila është në varësinë e Adminsitratorit të Fakultetit.		
	Studentët e pyetur gjatë vizitës në institucion u shprehën se nuk kanë pasur ankimum të rezultatit apo nevojën për rishikim.		
	[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 "Statute"; Annex No. 96 "Grade Appeal Form"]		
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UE u ka mundësuar studentëve përfaqësimin në organet vendimarrëse të institucionit, megjithatë njohja nga ana e studentëve pjesëmarrës në takim ishte e kufizuar. - Nuk ka asnjë evidencë për rishikim të programit të studimit në mbështetje të ndonjë propozimi nga studentët apo nga analiza e anketimit të tyre apo analiza e tregut. - UE duhet të kryejë një studim tregu për këtë program studimi dhe të konsiderojë opinionet e marra nga ALUMNI dhe pyetësorët e studentëve për rishikimin e programit të studimit. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në RVB evidentohet se Zyra e Regjistrimeve ndjek jetën akademike të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, mban të dhëna dhe evidenca sipas rregulloreve të UE. UE ka të angazhuar disa individë të cilët krahas punës si pedagogë kryejnë edhe këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Krahas Këshilltarit akademik, UE u afron studentëve mundësinë e aksesit paralelisht edhe përmes Dekanit të studentëve, Administratorit të Fakultetit etj. Konkretisht, sipas RVB-së, zyra e dekanit të studentëve është në komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe pranon kërkesat e studentëve në baza ditore. Për çështje akademike kërkesa e studentit, i drejtohet Dekanit të Studentëve, i cili më pas e dërgon për trajtim tek departamenti përkatës, fakulteti apo Zyra e Rektorit. Pas vlerësimit të kërkesës, Koordinator i Zyrës së Dekanatit të Studentëve informon studentët për vendimin lidhur me kërkesën. Gjithashtu, sipas RVB-së, Dekani i Studentëve u kërkon studentëve çdo fund semestri të plotësojnë
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje	

<p>me kompletimin e procesit mësues, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>një pyetësor për të mbledhur opinionet për përvojën dhe kënaqësinë e tyre në UE me qëllim të përputhjes së shërbimeve studentore të ofruara në UE.</p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar shërben për të orientuar studentët në gjetjen e fushave të mira të punës për ta dhe për të mbajtur dialogun e Universitetit me botën e biznesit.</p> <p>Në takimin me përfaqësuesin e kësaj zyre, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e kësaj strukture në bashkëpunim edhe me strukturat/zyrat e tjera të UE fokusohet në promovimin e programeve të studimit të UE përmes takimeve & informacioneve orientuese tek studentët potencialë, në ofrimin e këshillimit për zhvillimin e karrierës të studentëve aktualë të UE, si dhe në gjurmimin e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Nga evidencat shtesë të depozituara nga IAL, pas kërkesës së GVJ, rezultoi se kjo zyrë përgatit një raport vjetor mbi aktivitetin e saj që u vihej në dispozicion të gjitha strukturave të UE, që nga njësia bazë, si dhe bëhej pjesë e analizave vjetore të tyre.</p> <p><i>GVJ konstatoi se të dhënat e raportit të paraqitur i referohen vitit akademik 2019-2020, prandaj rekomandon që institucioni duhet të kudeset për përditësimin në kohë të analizave lidhur me gjurmimin dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi si edhe masat e marra nga organet drejtuese të IAL-së pas raportimeve të bëra nga kjo zyrë.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 "Statute"; Annex No. 3 "Basic Regulation"; Annex No. 9 "Alumni Survey"; Annex No. 67 "Student guide"; Doc. Shtese Raporti Vjetor i Dekanatit të Studentëve.pdf; Raporti Vjetor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar.pdf]</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Regjistrimeve, Dekani i Studentëve, Këshilltari Akademik etj janë strukturuar në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve pranë UE. - Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar shërben për të orientuar studentët në gjetjen e fushave të mira të punës për ta dhe për të mbajtur dialogun e Universitetit me botën e biznesit. - UE duhet të kudeset për përditësimin në kohë të analizave lidhur me gjurmimin dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi si edhe masat e marra nga organet drejtuese të IAL-së pas raportimeve të bëra nga strukturat në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe 64ctive64tra të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UE, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe 64ctive64tra të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Referuar RVB-së, UE e ka përmirësimin e teknikave të mësimdhënies në kuadrin strategjik dhe planin e veprimit të tij për periudhën 2018-2022, si rrjedhim, gjatë këtyre viteve ka punuar vazhdimisht në këtë drejtim. Një mekanizëm që ka përmirësuar metodat e mësimdhënies në UE, sipas GVB, ka qënë përfshirja e UE në Projektin Erasmus+ "Shkëmbimi Virtual Shqiptar i Universiteteve Europiane" (VALEU-X), i cili ka pasë si objektiv të përgjithshëm kualifikimin e stafit akademik në IAL shqiptare mbi metodologjitë moderne pedagogjike dhe didaktike për mjedise mësimore novatore ⁷ .
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin 64ctive64t të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Referuar RVB-së dhe anekseve përkatëse, evidentojmë se studentët duhet të plotësojnë "Anketën e Vlerësimit të Instrukturëve të Lëndës" në fund të çdo semestri. Kjo anketë merr opinionet e studentëve lidhur me përpikëmerinë e pedagogëve, përgatitjen e kursit, zotërimin e njohurive të lëndës, materialin e lëndës, ndërveprimin me studentët, metodat e mësimdhënies, vlerësimin e performancës së studentëve, ndarjen e kohës etj. Gjithashtu, një mënyrë për të dëgjuar shqetësimet e studentëve është nëpërmjet ankesës pranë Dekanit të Studentëve në lidhje me çështje të ndryshme të mësimdhënies, profesorëve, çështjeve financiare etj. GVJ e ka shprehur më sipër në këtë raport mendimin e tij për influencat negative që mund të krijohen nga përfshirja e Dekanit të studentëve në çështje që kanë të bëjnë me mësimdhënien.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nuk u evidentuan praktika konkrete në të cilat UE nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra nga anketimet e studentëve apo format e tjera të kishte promovuar raste konkrete dhe të evidentonte ato si shembuj të praktikave të mira, me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	

⁷ <https://projects.epoka.edu.al/home-erasmus-2359-1176.html>

	[Referenca: PSEER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 13 "UE Framework Strategy and Action Plan"; Annex No. 39 "Quality Assurance Handbook"; Annex No. 25 "Policy on Continuous Improvement of Study Programs"; Annex No. 93 "List of Staff trainings"; Annex No. 28 "Course Instructor Evaluation Survey"; Annex No. 38 "Students Request Form"]		
Konkluzione	GVJ konstaton se: - UE në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe kodit të cilësisë së Arsimit të Lartë, ka hartuar politika dhe udhëzime për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin e metodave dhe monitorimit duke ngritur struktura të posaçme në funksion të sigurimit të cilësisë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar RVB-së, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, me nënnyjësitë e tij si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve përbëjnë sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë të UE. Strukturat dhe parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC), UE i ka vendosur edhe në nenet 35 dhe 37 të Statutit, në Rregulloren "Për Funksionimin e KPSC" dhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë së UE. Gjithashtu, universiteti ka krijuar Politikën e Cilësisë që mbulon politikën në lidhje me parimet dhe standardet kryesore të sistemit të menaxhimit të cilësisë në përdorim në UE. Përmes Statutit është vendosur detyrimi i ngritjes së Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel Institucioni për UE. Gjatë vitit 2021, UE i është nënshtuar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Konkretisht, me vendimin Nr.54 të Bordit të Akreditimit, datë 16.12.2021 UBT ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 6 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 15.12.2027. Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Financë-Bankë" është akredituar për herë të parë me Urdhërin e Ministrit të
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	

<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Arsimit dhe Shkencës Nr. 286, datë 06.07.2012. Më pas ky program studimi është riakredituar me Vendimin Nr. 58 datë 28.09.2018 të Bordit të Akreditimit të ASCAL me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite akademike dhe me disa rekomandime në zbatim të këtij vendimi, për të cilat GVJ është shprehur në hyrje të këtij raporti.</p> <p>Institucioni ka përcaktuar tregues të qartë dhe të matshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta sipas Shtojcës nr. 27 të Direktivës për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë.</p> <p>GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit me objektiv rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet.</p> <p>[Referenca: RVB; vizita në institucion; Annex No. 1 "Statute of UE"; Annex No. 40 "Regulation on the Organization and Functioning of the PCQA"; Annex No. 27 "Directive on Academic and Administrative Performance Assessment and Quality Improvement"; Annex No. 39 "UE Quality Assurance Handbook; Annex No. 90 "UE Quality Policy"; Doc. Shtese vendimet per komisionet epoka]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UE në përmbushje të politikave të përmendura më sipër ka ngritur strukturat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional. - Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë ka në përbërjen e vet përfaqësim të studentëve dhe një ekspert të jashtëm. - UE ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 6 vite akademike. - Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Financë-Bankë" akreditohe për herë të tretë. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e</p>	<p>Referuar RVB-së, DFB për monitorimin dhe rishikimin e këtij programi studimi bazohet në rregulloren "Për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit". Propozimi i departamentit për përmirësimin e kurrikulës për programet e studimeve përkatëse fillimisht shqyrtohen nga Dekanati. Vendimi i Dekanatit mbi propozimet për përmirësim të programit të studimit dërgohet në Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave dhe propozimi për përmirësimin e programeve të studimit dërgohet për shqyrtim në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin të Cilësisë. Bazuar</p>

<p>praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>në vlerësimet e këtyre komisioneve, Senati Akademik merr vendimin përfundimtar mbi përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 "Statute of UE"; Annex No. 25 "UE Policy on Continuous Improvement of Study Program"]</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>UE harton raporte për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit me të dhëna për arritjet akademike të studentëve të mbledhura nga NJSBC. Bazuar në këto të dhëna ndërtohet edhe raporti vjetor i veprimtarisë së njësisë bazë deri tek ai institucional. Sipas RVB-së, UE përgatit një plan veprimi për të adresuar çështjet dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u dërgohen Departamenteve përgjegjëse për programin e studimit, Dekanateve, Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Rektoratit dhe Senatit Akademik.</p> <p>Senati Akademik i Universitetit "EPOKA" ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë si edhe njësitë mbështetëse. Megjithatë në respekt të kuadrit ligjor, Senati Akademik i UE vlerëson, garanton dhe është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore. Ndërsa përgjegjësia për funksionimin efektiv dhe eficient të këtij programi studimi dhe sigurimin e cilësisë së tij i përket DFB-së.</p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 "Statute of UE"; Annex No. 27 "UE Directive on Academic and Administrative Performance Assessment and Quality Improvement"; Annex No. 28 "Course Instructor Evaluation Survey Form"; Annex No. 29 "Academic Staff Satisfaction Survey Form"; Annex No. 64 "Institutional Annual Report"]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në narrativën dhe argumentimin e RVB-së si edhe evidencat e tjera në DVV, nuk evidentojmë të dhëna dhe evidenca lidhur me atë çfarë kërkohet në plotësim të kriterit 3 në këtë standard.</p> <p>Pavarësisht se në RVB janë cituar disa metoda të tilla si: Vlerësimi me pikë për pjesëmarrjen e nxënësit në klasë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; Vlerësimi i projekteve studimore dhe detyrave në grup; Diskutimi i rezultateve të provimit me studentët si dhe diskutimi mbi format e mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit nga ana e pedagogut, këto metoda janë në kuadër të vlerësimit të përgatitjes së studentit dhe jo për çfarë kërkohet kriteri 3 në këtë standard.</p> <p>Por GVJ konstaton se pranë UE funksion Bordi i Provimeve si strukturë në varësi të Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, që kujdeset në mënyrë të veçantë për cilësinë e provimeve pranë UE.</p> <p><i>[Referenca: Annex No. 30. EPOKA University Guideline "On Examinations".pdf; Annex No. 34. Directive of EPOKA University "On the Functioning of the Exam Board".pdf; vizita në institucion]</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e 68ctive68trative, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Referuar DVV-së, UE përdor metoda të tërthorta të vlerësimit si në vijim: <i>Anketa për Vlerësimin e Instruktorëve të Lëndës</i> kryhet nga studentët në fund të çdo semestri, ku studentët japin mendimin e tyre për ligjëruesin dhe përmbajtjen e lëndës. Në fund të çdo semestri, bazuar në rezultatet e pyetësorit, departamenti përkatës përgatit një raport i cili përfshin të dhëna sasiore, cilësore, analiza dhe plan veprimi; <i>Anketa e Kënaqësisë së Studentëve</i> në lidhje me shërbimin e kryer çdo vit nga Dekani i Zyrës së Studentëve; <i>Anketa e Alumni-ve</i> kryhet çdo vit akademik për të mësuar mbi zbatueshmërinë dhe praktikitetin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara si rezultat i programit të studimit; <i>Anketa e Kënaqshmërisë së Kompanisë</i> për të marrë komentet e duhura mbi performancën e të diplomuarve të UE në tregun e punës; <i>Anketa e Kënaqësisë së Stafit Akademik</i> për të marrë komentet e duhura nga stafi në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor e shërbimet. Gjithashtu, Bordi i Provimeve përgatit një raport vjetor në bazë semestrale për cilësinë e notave të provimeve dhe e dërgon atë tek Komisioni i Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë, të cilët e përcjellin në Senatin Akademik dhe më tej tek njësitë përkatëse për ndjekjen e çështjeve të ngritura.</p> <p><i>GVJ vlerëson si praktikë të mirë që UE përthith opinionin e studentëve, alumni, punëdhënës etj., përmes pyetësorëve të shpërndarë nga zyrat respektive.</i></p> <p>[Referenca: PSEr_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 "Statute of UE"; Annex No. 52 "Report related to the Student Satisfaction Survey Results"; Annex No. 9 "Decision of the Rectorate of UE No. 04, dated 01.03.2022 (Alumni Survey)"; Annex No. 10 "Company Satisfaction Survey"; Annex No. 29 "Academic Staff Satisfaction Survey Form"; Annex No. 39 "UE Quality Assurance Handbook" Annex No. 34 "Directive on the Functioning of the Exam Board"]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator i UE parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</i> - <i>Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës.</i> 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UE ka politika dhe procedura të brendshme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit duke përfshirë aktorë të brendshëm (staf akademik, administrativ e studentë) dhe të jashtëm (ekspertë apo të interesuar për rritjen e cilësisë në UE). Parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) gjenden që në nenet 35 dhe 37 të Statutit të UE e më tej në Rregulloren “Për Funksionimin e KPSC” dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë së UE.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 “Statute of UE”; Annex No. 39 “UE Quality Assurance Handbook”]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe 69cti të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nisur nga Statuti i UE dhe në dokumentat e tjera përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrat specifike të njësive kryesore, individëve, studentëve dhe palëve të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij programi studimi. Për më tepër ato gjenden në nenet: 11, 12, 15, 35, 37, 38, 108, 109 të Statutit të UE dhe informacionin në lidhje me strukturat e sigurimit të cilësisë të publikuar në faqen zyrtare⁸ të UE.</p> <p>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 “Statute of UE”; Annex No. 39 “UE Quality Assurance Handbook”]</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UE siguron përfshirjen e stafit akademike e drejtues të DFB dhe studentëve të këtij programi studimi në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së këtij programi përmes angazhimit në përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm, takimit me vlerësues të jashtëm, rishikimin e pyetësorëve etj. Gjithashtu, siç edhe është shkruar më sipër, gjatë zbatimit të instrumenteve matëse studentët aktualë dhe të diplomuar japin komentet e tyre për mësimdhënien, të nxënit dhe shërbimet përmes anketimeve të ndryshme. Edhe stafi akademik jep komentet e tij për mësimdhënien, kërkimin dhe shërbimet përmes anketës së kënaqësisë së stafit.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar RVB-së, aktorët e brendshëm të përfshirë dhe të angazhuar në procedurat e vlerësimit të vazhdueshëm në UE, nuk kanë qenë subjekt i asnjë lloj diskriminimi apo pabarazie. Të gjithë aktorët e brendshëm që janë pjesë e organeve të sigurimit të cilësisë kanë të njëjtën të drejtë vote dhe të shprehin shqetësimin si të gjithë anëtarët e tjerë. Megjithatë, kjo nuk është e shkruar dhe mbështetur me evidenca se si e siguron UE këtë, pavarësisht se në RVB janë shprehur se i takon Senatit Akademik të garantojë respektimin e parimeve të autonomisë, lirisë akademike dhe kërkimit shkencor, mundësi të barabarta si dhe të drejtat e studentëve sipas nenit 16 1) a të Statutit të UE, pasi në të njëjtën kohë është Senati Akademik që vlerëson, garanton dhe përgjigjet për sigurimin e cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore.</p>

⁸ <https://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html?lang=EN&dpid=2&t=quality-assurance-documents&catid=1404&menuid=1404>

	<i>[Referenca: PSEr_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 "Statute of UE"; Annex No. 39 "UE Quality Assurance Handbook"]</i>		
Kriteri 5. Pjesë 70cive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Referuar RVB-së, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë ka në përbërje një anëtar/ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues alumni bazuar në nenin 35 të Statutit të UE. Gjithashtu, gjatë zbatimit të instrumenteve matëse, alumni dhe punëdhënësit e tyre japin komente mbi zbatueshmërinë e njohurive të tyre përmes anketave. <i>[Referenca: PSEr_MSc_BAF_shqip.pdf; vizita në institucion; Annex No. 1 "Statute of UE"; Annex No. 95 "Report on Alumni Survey Results"; Annex No. 10 "Report on Company Satisfaction Survey"; Annex No. 95 "Alumni Survey"; Annex No. 39 "UE Quality Assurance Handbook"]</i>		
Konkluzione	GVJ konstaton se: - <i>Kuadri rregullator i UE përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit.</i> - <i>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë ka në përbërje një anëtar/ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues alumni.</i> - <i>UE siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ bazuar në hulumtimin e bërë në website të UE dhe takimet gjatë vizitës në IAL evidenton se politika ⁹ , strategjia ¹⁰ , organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të internetit të UE. Gjithashtu, UE kujdeset që gjatë sesionit orientues studentët e rinj të njihen me organizimin dhe aktivitetet e kryera në kuadër të sigurimit të cilësisë së programeve të studimit duke e përfshirë këtë informacion edhe në udhëzuesin e studentëve ¹¹ . <i>[Referenca: DVV; UE Website; vizita në institucion]</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të	GVJ konstaton se në faqen zyrtare të internetit të UE gjenden të publikuara raportet e vlerësimeve të jashtme por jo raportet e strukturave përgjegjëse

⁹ <http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html>

¹⁰ <http://aeqi.epoka.edu.al/cat-strategic-plans-1409.html>

¹¹ https://epoka.edu.al/mat/student_guide/2022/Student_Guide_2022_2023.pdf

<p>studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>të UE për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu siç u përmend edhe më herët, publikimet janë kryesisht në gjuhën angleze.</p> <p><i>GVJ rekomandon publikimin e raporteve të vlerësimit të realizuara nga strukturat e UE lidhur me cilësinë e programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale (në gjuhën shqipe dhe angleze).</i></p> <p><i>[Referenca: DVV; UE Website; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Siç u përmend edhe në kriteret 1 & 2 të Standardit VI.3, GVJ konstatoi se UE harton raporte për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit me të dhëna për arritjet akademike të studentëve të mbledhura nga NJSBC. Në këto raporte kryesisht bëhet një paraqitje përshkruese të proceseve dhe gjetjeve të tyre, por nuk përfshihet një plan masash për përmirësim të problematikave. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi që në UE plani i masave për përmirësimin e situatave të evidentuara realizohet nga strukturat drejtuese të institucionit (me vendim të Rektorit).</p> <p><i>GVJ rekomandon që në raportet e strukturës së NJSBC të përfshihet edhe një plan masash për përmirësimin e gjetjeve si dhe rekomandime për promovimin e praktikave pozitive.</i></p> <p><i>[Referenca: PSER_MSc_BAF_shqip.pdf; UE Website; Doc. Shtese Raporti i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UE kryen rishikime të akteve të brendshme rregullative me qëllim sigurimin e përmirësimin të cilësisë dhe përputhshmërinë me ndryshimet ligjore e rregullatore të kryera nga MAS dhe ASCAL.</p> <p>Gjithashtu në mbledhjet e departamentit, personeli akademik analizon ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor, punën kërkimore-shkencore, angazhimin administrativ, aktivitetet me studentët si dhe përcaktohen objektivat për vitin e ardhshëm akademik në funksion të përmirësimin të vijueshëm të cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: DVV; UE Website; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në DVV dhe takimet e kryera gjatë vizitës në IAL evidenton se UE organizon aktivitete me studentët dhe stafin lidhur me informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së këtij programi studimi. Në këto aktivitete përfshihen edhe përfaqësues nga strukturat përgjegjëse të sigurimit të cilësisë në UE. Gjithashtu, duke qënë se stafi dhe studentët kanë përfaqësuesit e tyre në organe të ndryshme përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UE, krijohet mundësia e përcjelljes së shpejtë të informacionit apo njohurive qoftë edhe informalisht tek pjesa tjetër e stafit apo studentëve.</p> <p><i>[Referenca: DVV; UE Website; vizita në institucion; Annex No. 18 "List of Training Activities"]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p>



	<p>- Publikimet në faqen zyrtare web të UE dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale por janë kryesisht në gjuhën angleze.</p> <p>- Raportet për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit kryesisht bëjnë një paraqitje përshkruese të proceseve dhe gjetjeve të tyre, por nuk përfshijnë një plan masash për përmirësim të problematikave.</p> <p>- UE angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë-Bankë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti EPOKA”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Infrastruktura fizike dhe organizative e përshtatshme për një proces mësimor efektiv dhe me standarde bashkëkohore.
2. Personel akademik i kualifikuar dhe i përkushtuar për një mësimdhënie cilësore.
3. Mbështetja ndaj studentëve përmes politikave të bursave dhe aktiviteteve të klubeve studentore.

Pika të dobëta

1. Kuadri rregullator i UE është shumë i përgjithshëm lidhur me fushat e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon departamenti, si dhe dokumentat strategjikë kanë nevojë të përditësohen. [Referenca: Fusha I, Standardi I.1 & I.2; Fusha II, Standardi II.3 & II.6]
2. Organizimi i disiplinave mësimore dhe veprimtarive të tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi nuk është plotësisht në përputhje me VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr.185/2021. [Referenca: Fusha II, Standardi II.1, II.3 & II.4, Fusha III, Standardi III.4]
3. Mungesa e raporteve të dedikuara të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe nga aktivitetet me aktorët e jashtëm në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programeve të studimit. [Referenca: Fusha II, Standardi II.5]
4. Qendrueshmëria relative e personelit akademik efektiv. [Referenca: Fusha IV, Standardi IV.1]
5. Mungesa e analizave të detajuara lidhur me kostot akademike dhe logjistike sipas programeve të studimit apo sipas cikleve të studimit. [Referenca: Fusha IV, Standardi IV.5]

Rekomandime

1. Institucioni duhet të rishikojë programin e studimit dhe të pasqyrojë ndryshimet në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.
2. Institucioni duhet të përditësojë kuadrin rregullator përkatës me përcaktime më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon departamenti, si dhe duhet të përditësojë dokumentat strategjikë në përputhje me zhvillimet në UE.
3. Institucioni duhet të hartojë raporte të dedikuara të përfitimeve/kontributeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe nga aktivitetet me aktorët e jashtëm në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programeve të studimit.
4. Institucioni duhet t'i kushtojë vëmendje të shtuar angazhimit të një personeli akademik të qendrueshëm, me kritere rekrutimi specifike sipas natyrës së programit të studimit dhe duhet të përditësojë në kohë dosjet e personelit akademik sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.
5. Institucioni duhet të realizojë një analizë të qartë dhe të detajuar lidhur me kostot akademike dhe logjistike sipas programeve të studimit apo sipas cikleve të studimit.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Banking and Finance" provided by the Higher Education Institution "EPOKA University"

Strengths and affirmations

1. The physical and organizational infrastructure suitable for an effective learning process, compared to the current number of students.
2. the commitment and expertise of the academic staff engaged at the study program.
3. Support provided to students through scholarship policies and student club activities.

Weaknesses

1. The institution regulatory framework is very general regarding the general and specific areas of the study program and research activity covered by the department. Also, the institution's strategic documents need to be updated. [Reference: Chapter I, Standard I.1 & I.2; Chapter II, Standard II.3 & II.6]
2. The organization of the disciplines and other teaching activities of this study program does not fully comply with the current regulatory framework [Reference: Chapter II, Standard II.1, II.3 & II.4; Chapter III, Standard III.4]
3. Lack of dedicated reports of benefits from cooperation agreements and activities with external actors in function of continuous improvement of the curriculum of study programs. [Reference: Chapter II, Standard II.5]
4. The relative stability of the academic staff in this study program [Reference: Chapter IV, Standard IV.1]
5. Lack of detailed analysis related to academic and logistical costs according to study programs and/or according to study cycles. [Reference: Chapter IV, Standard IV.5]

Recommendation

1. The institution should review the study program and reflect the changes as required by the current legal and regulatory framework.
2. The institution should update the relevant regulatory framework with more complete definitions in function of the specific nature of the study programs and research activity covered by the department, as well as should update the strategic documents in accordance with the developments in the EPOKA University.
3. The institution should draw up dedicated reports of benefits/contributions from cooperation agreements and from activities with external actors, for the continuous improvement of the curriculum of the study programs.
4. The institution must pay attention to the recruitment of a stable academic staff in accordance with the requirements of the current regulatory framework.
5. The institution should carry out a clear and detailed analysis regarding the academic and logistical costs according to the study programs or according to the cycle of studies.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen kryesisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X